



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 14

2000

Maj

P Ë R M B A J T J A

| | | |
|---------------------------------------|---|-----|
| Ligj nr.8610, datë 17.5.2000 | Për parandalimin e pastrimit të parave..... | 635 |
| Ligj nr.8611, datë 17.5.2000 | Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillim ndërkombëtar, për financimin e projektit "Ndërtimi dhe rehabilitimi i shkollave"..... | 642 |
| Ligj nr.8612, datë 17.5.2000 | Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran për ripranimin e personave në situatë të parregullt, të memorandumit të mirëkuptimit lidhur me të, si dhe të protokollit për zbatimin e saj" .. | 653 |
| Dekret nr.2628, datë 22.5.2000 | Për lirim ministri..... | 663 |
| Dekret nr.2629, datë 22.5.2000 | Për emërim ministri..... | 663 |
| Vendim i KM Nr.162, datë 13.4.2000 | Për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë "Universi", sh.p.k. në administrim, për mbylljen e procesit të administrimit dhe për kalimin e dokumentacionit financiar organit të hetimit..... | 664 |

| | | |
|---------------------------------------|--|-----|
| Vendim i KM Nr.172, datë 13.4.2000 | Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Maminas (km 1.6-2.7) pjesë e superstradës Tiranë-Durrës..... | 665 |
| Vendim i KM Nr.231, datë 11.5.2000 | Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës..... | 673 |
| Vendim i KM Nr.232, datë 11.5.2000 | Për dhënie ndihme familjeve të zonave verilindore, të cilat kanë humbur pjestarë të tyre gjatë periudhës së luftës në Kosovë, si rezultat i vrasjeve ose i shpërthimit të minave e të predhave në territorin e Republikës së Shqipërisë..... | 677 |
| Vendim i KM Nr.233, datë 11.5.2000 | Për mbështetjen e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike nga organet e ruajtjes së rendit..... | 679 |
| Vendim i KM Nr.234, datë 11.5.2000 | Për kriteret dhe rregullat e marrjes së mostrave dhe të vlerësimit të plehrave kimike..... | 679 |
| Vendim i KM Nr.238, datë 18.5.2000 | Për një ndryshim në vendimin nr.792, datë 24.12.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik"..... | 680 |
| Vendim i KM Nr.239, datë 18.5.2000 | Për largim dhe emërim në detyrë të Sekretarit të Këshillit..... | 681 |
| Vendim i KM Nr.241, datë 18.5.2000 | Për riorganizimin dhe funksionimin e komisionit të çmimeve të barnave..... | 681 |
| Vendim i KM Nr.242, datë 18.5.2000 | Për mbylljen e disa minierave të bakrit, mineraleve të tjera dhe fabrikave të pasurimit, në rrethet Has, Pukë, Mirditë, Shkodër dhe Korçë..... | 683 |
| Vendim i KM Nr.246, datë 18.5.2000 | Për ndryshime të kushteve të lidhjes së kontratave të shitjes, për apartamentet e ndërtuara me fonde shtetërore nga enti kombëtar i banesave..... | 684 |
| Vendim i KM Nr.248, datë 18.5.2000 | Për akordim ndihme për disa familje, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i fatkeqësive..... | 685 |
| Vendim i KM Nr.253, datë 18.5.2000 | Për organizimin e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike..... | 691 |
| Vendim i KM Nr.254, datë 18.5.2000 | Për një ndryshim në vendimin nr.552, datë 14.11.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për prodhimin, shumëzimin, përpunimin, vlerësimin, tregtimin, kontrollin e farave e fidanëve dhe për ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor"..... | 692 |

L I G J
Nr. 8610, datë 17.5.2000

PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e pastrimit të parave, të rrjedhura nga veprimtaria kriminale, si dhe luftën kundër krimit financiar.

Neni 2
Përkufizime

Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në këtë ligj termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Pastrim i parave” është qarkullimi dhe riqarkullimi i parave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale, më poshtë të quajtura “të papastra”.

Pastrimi i parave përfshin:

a) depozitimin, tjetërsimin, transferimin dhe /ose këmbimin e parave, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

b) fitimin e së drejtës së pronësisë kur subjekti ka dijeni mbi çdo lloj pasurie, që rrjedh nga veprimtaria kriminale apo nëpërmjet përdorimit të parave të papastra;

c) ndërmjetësimin në favor të një personi tjetër për depozitimin, tjetërsimin, transferimin dhe/ose këmbimin e parave, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

ç) pjesëmarrjen si ortak në personin juridik, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

d) bashkëpunimin në kryerjen e veprimeve të mësipërme, me veprim ose mosveprim, të kryera apo të mbetura në tentativë, si dhe fshehjen e pasojave të veprimtarisë kriminale. Këtu përfshihen edhe bashkëpunimi ndërmjet subjektit dhe klientit kriminal, që kryen veprën penale të pastrimit të parave, duke penguar dhënien e informacionit nga subjektet sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. “Klient”, për efekt të këtij ligji, është personi fizik (tregtar dhe jotregtar-individ) dhe personi juridik, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, publik ose privat.

3. “Autoritet Përgjegjës”, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative është “Agjencia e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave” pranë Ministrisë së Financave. Statusi juridik dhe pozicioni i këtij “Autoriteti Përgjegjës” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. “Cash”, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera normative është monedha në qarkullim, duke përfshirë kartmonedhën dhe monedhën metalike, kombëtare dhe/ose të huaj.

5. “Pezullim i veprimit financiar”, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative është ndërprerja e veprimit financiar nga “Autoriteti Përgjegjës”.

Neni 3 Subjektet

1. "Subjektet" janë personat fizikë ose juridikë, të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, që në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, kryejnë veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj.

Subjekte të tilla janë:

- a) Bankat dhe subjektet, që kryejnë veprimtari bankare dhe financiare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- b) zyrat e këmbimeve valutore;
- c) bursat;
- ç) fondet e investimeve;
- d) shoqëritë e sigurimeve dhe/ose risigurimeve dhe entet e tjera ligjore, që ushtrojnë veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi, të autorizuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve;
- dh) institucionet përgjegjëse në procesin e privatizimit;
- e) shërbimet postare, si dhe ndërmjetësuesit e tjerë që kryejnë shërbime pagesash;
- ë) shoqëritë që kryejnë veprimtari tregtare të lojrave të fatit apo kazinotë;
- f) ekspertët kontabël të autorizuar;
- g) çdo person fizik dhe juridik, veprimtaria tregtare e të cilit ka të bëjë me:
 - tregtinë e mjeteve të transportit;
 - veprimtaritë e transportit dhe spedicionit;
 - tregtimin e sendeve me vlerë dhe/ose antike;
 - vlerësimin e pasurive të paluajtshme;
 - administrimin e pronës së të tretëve;
 - veprimtarinë tregtare me metale të çmuar ose gurë të çmuar;
 - agjencitë e udhëtimeve;
- gj) avokatët, noterët dhe përfaqësuesit me prokurë;
- h) organet doganore e tatimore;
- i) filialet, degët, agjencitë apo zyrat e përfaqësimit të subjektit të huaj; brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- j) zyrat që evidentojnë transferimin apo tjetërsimin e pasurive.

Neni 4 Procedurat e identifikimit

1. Të gjitha subjektet e këtij ligji identifikojnë klientët, përpara kryerjes së veprimit financiar mbi shumat e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Subjektet identifikojnë klientët edhe në rastet kur ka të dhëna për pastrim të parave, të përfituara nga veprimtaria kriminale, megjithëse shumat e veprimit financiar mund të jetë poshtë kufijve të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

2. Identifikimi i klientëve nga subjektet realizohet nëpërmjet regjistrimit dhe mbajtjes, në dosje të veçantë, të të dhënave të mëposhtme:

- a) për personin fizik jotregtar (individ): emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi i përkohshëm dhe i përhershëm, si dhe numri dhe lloji i dokumentit zyrtar të identifikimit dhe organi që e ka lëshuar atë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar;
- b) për personin fizik tregtar: emri, mbiemri, numri dhe data e vendimit të gjykatës për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të subjektit, numri dhe data e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar;
- c) për personin juridik: emri, numri dhe data e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, numri i lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selia e përkohshme dhe e përhershme, natyra e veprimtarisë tregtare, qëllimi, lloji, data, shumat dhe monedha e veprimit financiar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

ç) për përfaqësuesin ligjor të klientit: emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, numri i dokumentit zyrtar të identifikimit dhe lëshuesi i këtij dokumenti, akti i përfaqësimit (prokura), si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative “Autoriteti Përgjegjës” përcakton formën dhe procedurën e regjistrimit të të dhënave.

3. Dokumentacioni i identifikimit i të gjithë klientëve mbahet në origjinal dhe është i vlefshëm brenda afatit ligjor të vlefshmërisë së tij. Në rast se në çastin e kryerjes së veprimit financiar nuk deklarohet shuma, subjektet e mësipërme identifikojnë klientin, sapo kjo shumë të deklarohet.

4. Të gjithë klientët, të cilët kërkojnë të kryejnë një veprim financiar mbi shumën e përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, deklarojnë përfituesit përfundimtarë të fruteve të pronës, burimin, natyrën dhe të ardhurat e përfituara nga qarkullimi i parave, duke përfshirë pagesat e bëra për sigurimet shoqërore.

Neni 5

Raportimi tek “Autoriteti Përgjegjës”

1. Subjektet e përcaktuara në këtë ligj regjistrojnë të gjitha veprimet financiare në cash të të gjithë klientëve për shumat mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, të huaja.

Pas regjistrimit të këtyre veprimeve, në rast se ka elementë të dyshimit për pastrimin e parave, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, subjektet i raportojnë “Autoritetit Përgjegjës” jo më vonë se 48 orë.

2. Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, i raportojnë “Autoritetit Përgjegjës” për të gjitha rastet e veprimeve financiare në cash dhe/ose transfertave të fondeve për shuma mbi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, të huaja.

3. Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, i raportojnë “Autoritetit Përgjegjës” për të gjitha veprimet financiare të klientëve mbi shumën prej 2 000 000 (dy milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, në rastet kur vërejnë:

a) parregullsi në veprimet financiare të klientit, të përcaktuara në nenin 2 pika 1, veçanërisht në depozitimet, transferimet, dhe/ose këmbimet e parave, si dhe emëtimin e instrumenteve të negociueshme (çek, kambial dhe prentim pagese);

b) rrethana të ndërlukuara, të pazakonta dhe të pajustificuara, në veprimet financiare;

c) se veprimet financiare të klientëve nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe ligjore;

ç) njoftime, se paratë rrjedhin nga veprimtaria kriminale;

d) se ka të dhëna për pastrimin e parave, që kanë lindur pas kryerjes së veprimit financiar, si dhe në çdo rast tjetër që nuk përfshihet më sipër, por ekzistojnë elementet e kryerjes së veprës penale të pastrimit të parave.

4. Subjektet e këtij ligji njoftojnë Autoritetin Përgjegjës për çdo të dhënë që pohon ose mohon dyshimet.

5. Të dhënat për “Autoritetin Përgjegjës” jepen vetëm nga administratorët, zyrtarët ose nëpunësit e autorizuar të subjekteve.

6. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, “Autoriteti Përgjegjës” përcakton formën dhe procedurën e verifikimit dhe të raportimit të të dhënave.

Neni 6

Detyrimet dhe të drejtat e subjekteve

1. Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimit për pastrimin e parave, në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative.

Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, detyrohen të mbajnë dhe të ruajnë:

a) të gjithë të dhënat për identifikimin e klientit, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga

data e përfundimit të marrëdhënieve juridike civile me subjektin;

b) të dhënat, njoftimet, raportimet për veprimin financiar në emër të klientit për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

2. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, subjektet kanë të drejtë të mos e kryejnë veprimin financiar në rast se:

a) klienti ose klientët nuk sigurojnë identitetin e plotë të tyre;

b) provohet anonimatit i tyre ose identiteti fiktiv;

c) kur kanë arsye (prova) që i shtyn të besojnë se veprimi financiar është i lidhur me pastrimin e parave, sipas përcaktimit të bërë në nenin 2 pika 1 të këtij ligji.

Neni 7

1. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, subjektet e këtij ligji detyrohen:

a) të caktojnë një drejtues të nivelit të lartë në qendër, filial, degë, agjenci ose zyrë përfaqësimi (në rast se kanë të tilla), ku të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e tjerë raportojnë të dhëna të mjaftueshme, që mund të jenë element i përcaktimit të bërë në nenin 5 të këtij ligji;

b) të sigurojnë krijimin e një qendre të grumbullimit të të dhënave;

c) të përgatisin dhe të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme të nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave;

ç) të informojnë periodikisht nëpunësit dhe punonjësit e tyre për procedurat ligjore të veprës penale të pastrimit të parave;

d) të organizojnë periodikisht programe kualifikimi për punonjësit;

dh) të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

e) të kujdesen që filialet, degët dhe agjencitë e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të veprojnë në përputhje me këtë ligj.

2. Në rast se numri i personelit të subjekteve, të përcaktuara në këtë ligj, është më pak se 3 (tre) veta, kërkesat e përcaktuara në nenin 7 pika 1, si më sipër, përmbushen nga vetë administratori ose nga personi i autorizuar, punonjës i subjektit.

Neni 8

Detyrat e “Autoritetit Përgjegjës”

1. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, “Autoriteti Përgjegjës”:

a) bën grumbullimin e të gjitha raporteve të sjella nga të gjitha subjektet e përcaktuara në këtë ligj;

b) bën verifikimin e të dhënave të raporteve të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj;

c) realizon kontrollin e procedurave, që kanë lidhje me raportin e dërguar nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj;

ç) kërkon të dhëna shtesë nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, nëse është e nevojshme;

d) mban, vlerëson, nxjerr në pah dhe ruan njoftimin dhe të dhënat e paraqitura;

dh) gjobit, pezullon me qëllim parandalimin e çdo veprimi, transferimi ose kalimi të pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

e) merr masat e nevojshme verifikuese;

ë) bashkëpunon me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'i njoftuar për identifikimin, gjetjen e burimit, bllokimin dhe sekuestrimin e pasurisë;

f) merr masat për përdorimin e teknikave verifikuese në identifikimin dhe në gjetjen e burimit të të ardhurave, si dhe mbledh të dhëna për to;

g) vlerëson rrezikshmërinë e veprës penale të pastrimit të parave, në përputhje me zhvillimet teknologjike, të cilat favorizojnë ruajtjen e anonimatit të veprimit financiar dhe merr masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parasë, me anë të këtyre teknologjive.

2. “Autoriteti Përgjegjës” vepron brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së raportit nga

subjekti.

Me veprim të “Autoritetit Përgjegjës” do të kuptohet vlerësimi i raportit të paraqitur nga subjekti dhe identifikimi i rrezikut të mundshëm në fushën bankare dhe financiare.

“Autoriteti Përgjegjës”, pasi ka vlerësuar dhe grumbulluar fakte të mjaftueshme për ekzistencën e veprës penale, bën kallëzimin në organin e prokurorisë.

3. “Autoriteti Përgjegjës” mban dhe ruan të dhënat, si dhe dokumentacionin tjetër ligjor për veprimet financiare, për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

4. Nëpunësit dhe punonjësit e “Autoritetit Përgjegjës” përdorin njoftimin dhe ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të marra vetëm në funksion të ushtrimit të detyrave dhe të pushteteve të parashikuara në këtë ligj.

5. “Autoriteti Përgjegjës” i kushton vëmendje të veçantë rrezikshmërisë së figurës të krimit të pastrimit të parave, kur zhvillimet teknologjike mund të favorizojnë ruajtjen e anonimatit të veprimit financiar dhe merr masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parasë, me anë të këtyre teknologjive.

Neni 9

Bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit.

Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, subjektet bashkëpunojnë me organet e drejtësisë, në masën që u lejohet nga ligji përkatës në fushën e konfidencialitetit të veprimeve financiare të klientit.

Neni 10

Raportimi i transaksioneve në pikat e kalimit kufitar.

1. Individët, rezidentë ose jorezidentë, që hyjnë e dalin në dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë, deklarojnë detyrimisht, shumat në cash ose çeqe udhëtari, në dhe mbi shumën 10 000 (dhjetë mijë) USD ose kundërvlerën në monedha të tjera.

2. Individët, qytetarë të huaj, që vizitojnë përkohësisht Shqipërinë, mund të nxjerrin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë valutë cash ose çeqe udhëtari, deri në masën e deklaruar, kur kanë hyrë, që justifikohet me paraqitjen në doganë të deklaratës përkatëse.

3. Organet doganore raportojnë menjëherë “Autoritetin Përgjegjës” në të njëjtën formë dhe mënyrë, sikurse parashikohet për subjektet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, në rastet kur:

- a) marrin njoftim për veprimtarinë e pastrimit të parave;
- b) vihet re moszbatimi i këtij ligji

Neni 11

Raportimi për veprimtaritë bankare

Për veprimtaritë bankare që përfshijnë transaksione, transferta dhe veprime të tjera ndërkombëtare nga bankat shqiptare ose subjektet e licencuara, që kryejnë veprimtari financiare dhe bankare në Shqipëri, veprohet në përputhje me aktet nënligjore përkatëse të lëshuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 12

Mbrojtja e të drejtave të subjekteve

Subjektet e përcaktuara në këtë ligj ose personat përfaqësues të këtyre subjekteve, si dhe punonjësit e tyre, që raportojnë me mirëbesim, përjashtohen nga përgjegjësia ligjore (penale dhe civile) e ruajtjes së sekretit (përfshirë dhe atë bankar) dhe e të dhënave tregtare konfidenciale të klientëve.

Neni 13

Detyrimet e autoriteteve mbikëqyrëse

Autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, në rast se gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre institucionale vërejnë se ka elemente të pastrimit të parasë, njoftojnë “Autoritetin Përgjegjës”, për të parandaluar pastrimin e parave, sipas së njëjtës formë dhe mënyrë, sikurse parashikohet për të gjithë subjektet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

1. Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve nga subjektet që veprojnë në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 6 pika 1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë, deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

2. Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve nga drejtuesit e nivelit të lartë të subjekteve të autorizuara sipas nenit 7 pika 1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve nga personat e punësuar pranë subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, të cilët qëllimisht:

a) bashkëpunojnë në fshehjen ose maskimin e natyrës së veprimit financiar, të origjinës së tij, në ndryshimin e përcaktimit të burimit të parave të rrjedhura drejtpërdrejt ose tërthorazi nga veprimtaria kriminale;

b) përpiqen të pranojnë një identitet të rremë;

c) me vetëdije prishin ose ndryshojnë regjistrat dhe nuk raportojnë transfertat ndërkombëtare të fondeve ose të letrave me vlerë;

të cilat nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

4. Gjyba në çdo rast vendoset nga “Autoriteti Përgjegjës”.

Procedura e ankimit dhe ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.11993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 15

Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare

1. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, “Autoriteti Përgjegjës” dhe organizatat ose institucionet ndërkombëtare simotra bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna, me qëllim:

a) investigimin dhe marrjen e masave ligjore, që kanë për qëllim konfiskimin e mjeteve dhe të të ardhurave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale;

b) dhënien e ndihmës maksimale në identifikimin dhe me gjetjen e burimit të mjeteve, të të ardhurave dhe të pasurive të tjera, që do t'i nënshtrohen konfiskimit. Kjo ndihmë do të realizohet në përputhje me ligjet përkatëse të secilit vend.

2. “Autoriteti Përgjegjës” dhe organizatat ose institucionet ndërkombëtare simotra i japin njëra-tjetrës ndihmë maksimale të ndërsjellë, në shkëmbimin e dokumenteve ligjore, për personat që u janë nënshtruar masave ligjore dhe konfiskimit.

3. Procedurat e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare simotra për ekstradimin e personave të përfshirë në pastrimin e parave dhe të konfiskimit të pasurive zbatohen në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

4. Të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë nen do të bëhen me shkrim. Mund të përdoren edhe mjete të tjera të telekomunikacionit, të përcaktuara nga “Autoriteti Përgjegjës”.

5. “Autoriteti Përgjegjës” harton programe frytdhënëse, ku përfshihet bashkëpunimi dhe

asistenca e ndërsjellë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave në vende të ndryshme.

6. “Autoriteti Përgjegjës” ka të drejtë të marrë pjesë dhe të nënshkruajë marrëveshje.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2636, datë 26.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr. 8611, datë 17.5.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC- UT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI DHE REHABILITIMI I SHKOLLAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillim ndërkombëtar, për financimin e projektit “Ndërtimi dhe rehabilitimi i shkollave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2637, datë 26.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

FONDI OPEC PËR ZHVILLIMIN NDËRKOMBËTAR

MARRËVESHJE me datë 25/02/2000 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (në të ardhmen do të referohet si Huamarrësi) dhe Fondi i OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar (në të ardhmen do referohet si Fondi).

Ndërsa shtetet anëtare të OPEC, duke qënë të ndërgjegjshëm për nevojën e solidaritetit ndërmjet gjithë vendeve në zhvillim dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit financiar midis tyre dhe vendeve të tjera në zhvillim, kanë vendosur që Fondi të japë mbështetje financiare për vendet e fundit mbi bazë të termave koncesionale përveç kanaleve ekzistuese bilaterale dhe multilaterale nëpërmjet të cilave shtetet anëtare të OPEC-ut zgjerojnë asistencën financiare për vendet e tjera në zhvillim.

Dhe meqëse Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga Fondi për financimin e Projektit të

përshkruar në afatin 1 të kësaj Marrëveshje.

Dhe meqëse Bordi Udhëheqës i Fondit ka aprovuar rritjen e huasë ndaj Huamarrësit në shumën e 4.500.000 \$ US (katër milionë e pesëqind mijë) dollarë sipas termave dhe kushteve të parashtruara këtej e tutje;

Tani, sidoqoftë, palët veç kësaj, bien dakort për sa vijon:

Neni 1 Përkufizimet

1.1. Kudoqoftë e përdorur në këtë Marrëveshje, përveç kur teksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a) “Fond” nënkupton Fondin OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar të përcaktuar nga Shtetet Anëtare të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Petroliumit në bazë të Marrëveshjes të nënshkruar në Paris më 28, Janar 1976, siç amendamohet.

b) “Udhëheqja e Fondit” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Fondit ose përfaqësuesin e tij të autorizuar.

c) “Hua” nënkupton huanë e dhënë me anë të kësaj Marrëveshje.

d) “Dollar” ose shenja “\$” nënkupton monedhën monetare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

e) “Projekt” nënkupton projektin për të cilën Huaja jepet siç përshkruhet në Afatin 1 të kësaj Marrëveshje dhe përshkrimi nga ku mund të bëhet ndryshim kohe pas kohe sipas marrëveshjes ndërmjet Huamarrësit dhe Udhëheqjes së Fondit.

f) “Mallra” nënkupton pajisjet, furnizimet dhe shërbimet e kërkuara për Projektin. Referenca për koston e mallrave do të gjykohet në mënyrë që të përfshijë koston e importimit të këtyre mallrave në territorin e huamarrësit.

g) “Agjencia Ekzekutive” nënkupton Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Huamarrësit ose agjenci tjetër të tillë siç mund të bihet dakord në të ardhmen midis Huamarrësit dhe Udhëheqjes së Fondit.

h) “Data Përfundimtare” nënkupton datën e specifikuar në ose në vijim të Seksionit 2.10 të kësaj Marrëveshjeje.

i) “Data e vlefshme” nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe veprim.

Neni 2 Huaja

2.1. Një hua në shumën e 4.500.000 \$ US (katër milionë e pesëqind mijë US) dollarë të rritur nga Fondi për Huamarrësin sipas termave dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje.

2.2. Marrësi do të paguajë interesat në shkallën një për qind (1%) në vit për themeloret e Huasë të tërhequr dhe të papaguar kohë pas kohe.

2.3. Marrësi do të paguajë kohë pas kohe një taksë shërbimi në shkallën një për qind (1%) në vit për themeloret e Huasë të tërhequr dhe të papaguar, për të plotësuar shpenzimet e administrimit të Huasë.

2.4. Interesi dhe shpenzimet e shërbimeve do të paguhet në Dollarë në afate gjashtëmujore në 15 Janar dhe 15 Korrik për çdo vit në llogarinë e Fondit të specifikuar për këtë qëllim nga Drejtoria e Fondit.

2.5. Pasi kjo Marrëveshje të deklarohet e efektshme sipas Seksionit 7.01, dhe nëse Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe, të ardhurat e Huasë mund të tërhiqen kohë pas kohe për të përmbushur shpenzimet e bëra mbas 31 Gushtit 1999, ose të bëra në datat e mëvonshme duke respektuar koston e arsyeshme të mallrave që nevojiten për Projektin të cilat do të financohen nga të ardhurat e huasë siç paraqitet në Grafikon 2 të kësaj Marrëveshje dhe në amendamentet e këtij Grafiku të aprovuar nga Drejtoria e Fondit.

2.6. Përveç se në rast se Drejtoria e Fondit do të bjerë dakord ndryshe, tërheqjet nga Huaja

mund të bëhen në monedhat në të cilat shpenzimet e referuara në Seksionin 2.05 janë paguar ose janë të pagueshme. Në rast se pagesa kërkohet të paguhet në një monedhë tjetër përveç dollarit, pagesa e tillë do të kryhet në bazë të kostos aktuale të dollarit të marrë nga Fondi në përmbushjen e kërkesës. Drejtoria e Fondit do të veprojë në blerjen e monedhave si Agjenti i Huamarrësit. Tërheqjet në lidhje me shpenzimet në monedhën e Huamarrësit, në se ka ndonjë, do të bëhen në dollarë sipas kursit zyrtar të shkëmbimit në kohën e tërheqjes, dhe në mungesë të kësaj, sipas një kursi të arsyeshëm që Drejtoria e Fondit, kohë pas kohe do të vendosë.

2.7. Aplikimet për tërheqje do të paraqiten në drejtorinë e Fondit nga përfaqësuesi i Huamarrësit i emëruar ose në përputhje me, seksionin 8.02. Çdo aplikim i paraqitur në këtë mënyrë do të shoqërohet me këto dokumenta dhe dëshmi të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur Drejtorinë e Fondit se Huamarrësit i është dhënë e drejta të tërheqë nga huaja shumë e kërkuar dhe se shuma që do të tërhiqet do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e specifikuar në Marrëveshje.

2.8. Huamarrësi do të kthejë borxhin e huasë në dollarë ose në çdo monedhë tjetër të lirë për t'u shkëmbyer dhe të pranueshme nga Drejtoria e Fondit në një shumë ekuivalente me shumën e duhur në dollarë, sipas kursit mbizotërues të shkëmbimit në treg në kohën dhe vendin e kthimit. Kthimi i borxhit do të kryhet në 24 këste të barabarta gjashtë mujore duke filluar në 15 Janar 2005, pas një periudhe mirëbesimi duke iu afuar asaj date dhe pas kësaj në përputhje me afatin e amortizimit të aneksuar në këtë Marrëveshje. Çdo këst do të jetë në shumën e 187500 \$ (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) dollarë dhe të gjitha këto këste do të transferohen në datën e kthimit në llogarinë e Fondit siç kërkohet nga Drejtoria e Fondit.

2.9. (a) Huamarrësi angazhohet të sigurojë se asnjë kredi tjetër e jashtme nuk do të ketë prioritet mbi këtë Hua, në akordim, realizim, apo shpërndarjen e shkëmbimit të huaj të mbajtur nën kontroll ose në dobi të Huamarrësit. Për këtë qëllim, nëse ndonjë obligacion do të krijohet nga pasuritë publike (siç përcaktohet në seksionin 2.09) si siguracion për çdo borxh, i cili do të, ose mund të rezultojë në një prioritet për të mirë të kreditorit të borxhit të jashtëm në akordimin, realizimin, ose shpërndarjen e shkëmbimit të huaj, obligacioni, ipso facto dhe asnjë kosto mbi Fondin, do të sigurojë në mënyrë të barabartë principalin dhe shpenzimet mbi Huanë dhe Huamarrësi në krijimin ose lejimin e lindjes së këtij obligacioni, do të shprehë kushtet për këtë efekt; me kusht, që në qoftë se për ndonjë arsye ligjore ose konstitucionale ai kusht nuk mund të kryhet në lidhje me çdo obligacion të krijuar nga asetet e ndonjë nga ndërmarrjet vartëse administrative dhe politike, Huamarrësi do të sigurojë menjëherë dhe pa asnjë kosto për Fondin, principalin dhe shpenzimet mbi Huanë me anë të një obligacioni ekuivalent mbi asetet e tjera publike të mjaftueshme për Fondin.

(b) Sipërmarrja e mësipërme nuk do të zbatohet për:

(i) ndonjë obligacion të krijuar mbi pasurinë, në kohën e blerjes nga ku, vetëm si siguracion për pagesën e çmimit të blerjes të kësaj pasurie; dhe

(ii) çdo obligacion që del në kursin e zakonshëm të transaksioneve bankare dhe sigurimin e borxhit duke u maturuar jo më tepër se një vit mbas datës.

(c) Siç përdoret në këtë seksion, termi “asete publike” nënkupton asetet e Huamarrësit, ose të ndonjë nëndarje politike ose administrative nga ku ose prej ndonjë enti në pronësi ose nën kontroll, ose që vepron për llogari dhe interes të Huamarrësit ose të ndonjë nga ndërmarrjet në vartësi, duke përfshirë arin dhe asetet e tjera të shkëmbimit të huaj të mbajtur nga ndonjë institucion që kryen funksionet e bankës qendrore ose të fondit stabilizues të shkëmbimit, ose funksione të ngjashme, për Huamarrësin.

2.10. E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga të ardhurat e huasë do të përfundojë më 31 Dhjetor 2002, ose një datë më e vonshme siç do të vendoset nga Drejtoria e Fondit. Drejtoria e Fondit do të informojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 3

Zbatimi i projektit

3.1. Huamarrësi do të zbatojë Projektin me eficiencën e duhur dhe në përputhje me praktikat

e sakta inxhinierike, financiare, administrative, dhe do të sigurojë menjëherë sa po të nevojitet, fondet, lehtësirat, shërbimet dhe burime të tjera, përveç fitimeve të Huasë të kërkuara për këtë qëllim.

3.2. Huamarrësi do të sigurojë se aktivitetet e departamenteve dhe agjencive të tij në lidhje me zbatimin e Projektit janë drejtuar dhe bashkërenduar në përputhje me politikat dhe procedurat korrekte administrative.

3.3. (a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë, ose të kryejë parapërgatitjet e nevojshme për sigurimin e mallrave të importuara që do të financohen nga Huaja kundrejt incidenteve të rrezikshme nga përvetësimi, transportimi dhe shpërndarja deri në vendin e përdorimit ose instalimit, dhe për sigurime të tilla çdo dëmshpërblim do të paguhet në monedhën me qarkullim të lirë të përdorshëm nga Huadhënësi, për të zëvendësuar ose riparuar këto mallra.

(b) Me përjashtim veçse në se Fondi do të bjerë dakord ndryshe, të gjitha mallrat dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huasë do të përdoren ekskluzivisht për Projektin.

(c) Po të mos të bien dakort ndryshe Huamarrësi dhe Fondi, "Udhëzimet për Prokurimin e Huasë të dhëna nga Fondi OPEC" siç është aprovuar në 2 Nëntor 1982, një kopje e të cilës i është dhënë Huamarrësit, do të zbatohen për prokurimin e mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje.

3.4. (a) Huamarrësi do të paraqesë tek Drejtoria e Fondit, menjëherë sapo të përgatiten planet, specifikimet, dokumentet kontraktuese dhe afatet e ndërtimit dhe prokurimit për Projektin dhe ndonjë modifikim material dhe për pasojë shtesa, në detaje të tilla aq sa Drejtoria e Fondit do të kërkojë me maturi.

(b) Huamarrësi:

(i) do të mbajë protokollat dhe procedurat adekuate për të protokolluar dhe monitoruar progresin e Projektit (duke përfshirë koston e tij dhe dobitë që rrjedhin prej saj), të identifikojë mallrat dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huasë, dhe të sqarojë përdorimin e tyre në Projekt;

(ii) do të mundësojë përfaqësuesit e Fondit të vizitojnë qendrat e ndërtimit të përfshira në Projekt dhe të ekzaminojë mallrat dhe punimet të financuara nga të ardhurat e Huasë dhe çdo shënim dhe dokument të lidhur me të, dhe

(iii) do të përcjellë tek Fondi, në intervale të rregullta, të gjithë këtë informacion siç Fondi do të kërkojë me maturi që ka të bëjë me Projektin, koston e tij dhe, ku është e përshtatshme, dobitë e rrjedhura prej saj, shpenzimet e të ardhurave të huasë dhe mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga këto të ardhura si dhe një raport tremujor mbi progresin në zbatimin e Projektit.

(c) Menjëherë mbas mbarimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj mbas datës përfunduese, ose të një date të mëvonshme siç mund të bien dakort për këtë qëllim pas konsultës midis Huamarrësit dhe Drejtorisë së Fondit, Huamarrësi do të përgatisë dhe dorëzojë tek Fondi një raport, me detaje të tilla ashtu siç Fondi do ta shohë të arsyeshme ta kërkojë, mbi ekzekutimin dhe veprimin fillestar të Projektit, koston e tij dhe dobitë e rrjedhura dhe që do të lindin nga ai, plotësimin nga ana e Huamarrësit dhe Fondit të detyrimeve të tyre reciproke sipas kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushjen e qëllimeve të Huasë.

3.5. Huamarrësi do të mirëmbajë dhe të bëjë që të mbahen protokollat e duhura për të reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet në përputhje me praktikën llogaritëse të mbajtura në mënyrë konsekuente, në lidhje me Projektin, të departamenteve ose Agjencive të Huamarrësit përgjegjës për kryerjen e Projektit dhe ndonjë pale tjetër dhe të mbajë protokolle të vlefshme për Fondin sipas kërkesës së saj.

3.6. (a) Huamarrësi dhe Fondi do të bashkëpunojnë plotësisht për të bërë të sigurtë se qëllimet e Huasë do të përmbushen.

(b) Huamarrësi do të informojë menjëherë Drejtorinë e Fondit për çdo kusht që ndërhyr, ose kërcënon të ndërhyjë në progresin e Projektit, në kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, ose realizimin e qëllimeve të Huasë.

(c) Huamarrësi dhe Fondi kohë pas kohe do të shkëmbejnë pikëpamjet sipas kërkesës së secilës palë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në lidhje me çdo problem që ka të bëjë me Projektin dhe Huanë.

3.7. Të gjitha referencat për Huamarrësin në këtë Nen do të interpretohen duke përfshirë

referencat për Agjencinë Ekzekutive.

Neni 4 **Përfundimet**

4.1. Kjo Marrëveshje dhe çdo marrëveshje shtesë ndërmjet Palëve do të jetë e lirë nga çdo taksë, tatime ose vënie detyre e mbledhjes së takasave, ose në territorin e Huamarrësit në lidhje me ekzekutimin, shpërndarjen ose regjistrimin nga ku bëhet.

4.2. Themelori, interesi dhe shpenzimet e shërbimeve mbi Huanë do të paguhet pa zbritje dhe të lira nga ndonjë shpenzim dhe kufizim i çdo lloji të tatuar në territorin e Huamarrësit.

4.3. Të gjitha dokumentet, protokollat, korrespondenca dhe materiale të përafërta do të konsiderohen konfidenciale nga Huamarrësi, veçse kur është rënë dakord ndryshe me Fondin.

4.4. Fondi dhe asetet e tij nuk do t'i nënshtrohen asnjë mase të shpronësimit, nacionalizimit, sekuestrimit, kujdestarisë ose grabitjes në territorin e Huamarrësit.

Neni 5 **Përsheptimi i maturitetit, pezullimi dhe anulimi**

5.1. Në qoftë se ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme do të ndodhë ose do të vazhdojë për një periudhë të specifikuar si më poshtë, atëherë në çdo kohë pasuese gjatë vazhdimin të kësaj ngjarje, Drejtoria e Fondit mund t'i bëjë njoftim Huamarrësit ku deklarohet themelori i Huasë, pastaj e papaguara bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme menjëherë së bashku me interesin dhe shpenzimet e shërbimeve, për pasojë në atë rast themelori së bashku me interesat dhe të gjitha shpenzimet, do të bëhet i detyrueshëm dhe i pagueshëm menjëherë.

(a) Një mospagim mund të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej tridhjetë ditësh në pagesën e ndonjë kësti të themelorit ose të interesit ose të shpenzimeve të shërbimit sipas kësaj Marrëveshje ose sipas ndonjë marrëveshje tjetër me anë të të cilit Huamarrësi ka, ose do të marrë një hua nga fondi;

(b) Një mospagim mund të ndodhë në përmbushjen e ndonjë detyrimi mbi pjesën e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje ose sipas Projekt marrëveshjes, në qoftë se ndonjë, mospagim i tillë do të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit nga ku do të jenë dhënë nga Fondi tek Huamarrësi.

5.2. Huamarrësi pas njoftimit të Fondit mund të pezullojë ndonjë shumë të Huasë të cilën Huamarrësi nuk do ta ketë tërhequr përpara dhënies së këtij njoftimi. Fondi pas njoftimit të Huamarrësit mund të mbajë pagesën ose t'i japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja nëse ndonjë nga ngjarjet e përmendura në Seksionin 5.01 (a) dhe (b) do të ndodhin, ose në qoftë se do të krijohet ndonjë situatë tjetër e jashtëzakonshme, e cila do të bëjë të pamundur që Projekti të zbatohet me sukses, ose që Huamarrësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje.

5.3. Pavarësisht nga përsheptimi i maturitetit të Huasë në pajtim me Seksionin 5.01 ose të pezullimit ose anulimit në pajtim me Seksionin 5.02, të gjitha klauzolat e kësaj Marrëveshje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe veprim përveç se siç jepet specifikisht në këtë Nen.

5.4. Nëse bihet dakord ndryshe, ndërmjet Huamarrësit dhe Drejtorisë së Fondit, ndonjë anulim do të aplikohet pro rata për disa maturitete të shumës themeltare të Huasë e cila do të maturohet pas datës së këtij anulimi.

Neni 6 **Hyrja në fuqi, përfundimi i fondit, arbitrariteti**

6.1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në këtë Marrëveshje do të jenë të vlefshme dhe në fuqi në përputhje me termet e tyre pavarësisht nga ndonjë ligj vendas që është në kundërshtim. Asnjë palë në këtë Marrëveshje nuk ka të drejtë që e varur prej ndonjë rrethane, të shpallë ndonjë ankim, se ndonjë klauzolë e kësaj marrëveshje është e pavlefshme, ose jo në fuqi për ndonjë arsye.

6.2. Drejtoria e Fondit do të informojë menjëherë Huamarrësin kurdo herë që ndonjë vendim është marrë për shpërndarjen e Fondit në përputhje me Marrëveshjen e Themelimit të Fondit. Në rast të kësaj shpërbërje, kjo Marrëveshje Huaje do të mbetet në fuqi dhe Drejtoria e Fondit do të këshillojë Huamarrësin për çdo parapërgatitje zëvendësuese për shpërblimin e Huasë siç mund të gjykohet nga autoritetet përkatëse të fondit në kësi rastesh.

6.3. Palët në këtë Marrëveshje do të përpiqen të zgjidhin miqësisht të gjitha konfliktet ose ndryshimet midis tyre, që ngrihen nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me këtë. Në qoftë se konflikti ose kundërshtimi nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo duhet ti nënshtrohet Arbitrazhit në Gjykatën e Arbitrazhit siç jepet më poshtë:

a) Procedurat e Arbitrazhit mund të fillohen nga Huamarrësi kundrejt Fondit ose vice versa. Në të gjitha rastet, procedurat e arbitrazhit do të fillojnë me një lajmërim të dhënë nga pala paditëse palës së paditur.

b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitrarë të zgjedhur si më poshtë: një nga pala paditëse, një i dytë nga pala e paditur dhe një i tretë (këtej e tutje të quajtur Umpire-Arbitri) me marrëveshje të të dy arbitrareve. Në qoftë se brenda tridhjetë ditëve pas njoftimit të institutit të procedurave të arbitrazhit pala e paditur dështon të zgjedhë një arbitrar, ky arbitër do të zgjidhet nga presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë sipas kërkesës së palës që filloi procedimet.

Në qoftë se të dy arbitrat nuk arrijnë të bien dakord për Umpire brenda gjashtëdhjetë ditëve pas datës së caktimit të arbitrit të dytë, ky Umpire do të caktohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

c) Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në kohën dhe vendin e përcaktuar nga Umpire, dhe pas kësaj, ajo do të vendosë ku dhe kur do të ulet. Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë të gjitha çështjet e procedurës dhe çështjet që lidhen me kompetencën e saj.

d) Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të përcaktohen me shumicë vote. Vendimi i Gjykatës, i cili mund të ekzekutohet edhe në qoftë se një palë mungon, do të jetë final dhe detyrues për të dyja palët sipas procedurave të arbitrazhit.

e) Shërbimet e ndonjë njoftimi ose procesi në lidhje me çdo procedurë sipas këtij Seksioni ose në lidhje me procedurat që të hyjë në fuqi ndonjë vendim i dhënë në pajtim me këtë Seksion do të bëhen në mënyrën e dhënë në Seksionin 8.01.

f) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë mënyrën në të cilën kostoja e arbitrazhit do të mbahet nga secila ose të dy palët në konflikt.

Neni 7

Data efektive, mbarimi i kësaj marrëveshje

7.1. Kjo Marrëveshje do të bëhet e vlefshme në datën në të cilën Fondi i dërgon Huamarrësit njoftimin e pranimin të evidencës të kërkuar nga Seksioni 7.02 dhe 7.03.

7.2. Huamarrësi do të furnizojë Fondin me evidenca të mjaftushme se ekzekutimi dhe shpërndarja e kësaj Marrëveshje nga ana e Huamarrësit është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet sipas kërkesave konstitucionale të Huamarrësit.

7.3. Duke iu referuar Seksionit 7.02 Huamarrësi gjithashtu do ti japë Fondit një certifikatë të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, ose Prokurori i Përgjithshëm, ose Departamenti kompetent legal i Qeverisë ku tregohet se kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ratifikuar nga Huamarrësi siç duhet dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me këto kushte.

7.4. Në qoftë se kjo Marrëveshje nuk do të ketë hyrë në fuqi dhe në veprim nga _____ kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve do të mbarojnë, veçse në se Fondi, pas shqyrtimit të arsyeve për vonesën, do të vendosë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij Seksioni.

7.5. Kur e tërë shuma e principalit të Huasë do të jetë kthyer dhe interesi dhe të gjitha shpenzimet të cilat do të jenë rritur nga Huaja do të jenë rikthyer, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve deri këtu do të pushojnë menjëherë.

Neni 8

Njoftimi, përfaqësimi, modifikimi

8.1. Çdo njoftim ose kërkesë e kërkuar ose lejuar për t'u dhënë sipas kësaj Marrëveshje do të jetë me shkrim. Këto lloj njoftimesh dhe kërkesash duhet të gjykohen që të jepen dhe bëhen siç duhet, kur ato shpërndahen me dorë, postë, teleks, telefaks, palës që kërkohet ti jepet ose bëhet, në adresën e palës të specifikuar poshtë ose në ndonjë adresë që pala do të ketë specifikuar me shkrim palës që i jep njoftimin ose i bën kërkesën.

8.2. Çdo veprim i kërkuar ose lejuar të ndërmerret, dhe çdo dokument i kërkuar ose lejuar të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit do të merret ose ekzekutohet nga Ministri i Financave të Huamarrësit, ose ndonjë nënpunës tjetër i autorizuar prej tij me shkrim.

8.3. Çdo modifikim për klauzolat e kësaj Marrëveshjeje mund të bien dakord në emër të Fondit nga Kryetari i Bordit Drejtues të Fondit dhe në emër të Huamarrësit me dokument me shkrim të ekzekutuar në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i emëruar, ose pasues nga Seksioni 8.02, me kusht që në bindjen e këtij përfaqësuesi modifikimi është i arsyeshëm në kushtet e dhëna dhe nuk do të rrisë së tepërmi detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje. Fondi mund të pranojë ekzekutimin nga ky përfaqësues të ndonjë instrumenti si evidencë vendimtare që për opinionin e Huamarrësit modifikimi ose amplifikimi i kërkuar nga ky instrument nuk do të rrisë së tepërmi detyrimet e Huamarrësit këtej e tutje.

8.4. Çdo dokument i shpërndarë në vijim të kësaj Marrëveshjeje do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në gjuhë tjetër do të shoqërohen nga përkthimi anglisht ku është vërtetuar se është përkthim i aprovuar dhe ky përkthim i aprovuar do të jetë përfundimtar për palët.

Në prani, për më tepër, të palëve që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet dhe të shpërndahet në Vjenë në tre kopje në gjuhën Angleze, ku secila konsiderohet si origjinale dhe me të njëjtin efekt si edhe e ditës dhe e vitit të shkruar më sipër.

PËR HUAMARRËSIN:

Emri: Anastas Angjeli
Ministër i Financave

Adresa: Ministria e Financave

Bulevardi: Dëshmorët e Kombit
Tiranë,
SHQIPËRI
Telefaks : 00355 42 28494

PËR FONDIN OPEC PËR ZHVILLIMIN NDËRKOMBËTAR

Emri: Saleh Al-Omair
Drejtor i Bordit

Adresa: Fondi OPEC
për zhvillimin ndërkombëtar

P.O. Box 995
A-1011 Vjenë
Austria
Telegraf: OPECFUND
Telex: 131734 FUNDA
Telefaks: 5139238

AFATET

Afati 1: Përshkrimi i Projektit
Afati 2 : Akordimi i Huasë
Afati 3 : Afati i Amortizimit

AFATI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti përbën një pjesë integrale të programit të zhvillimit të shkollave të Huamarrësit dhe programit të kapacitetit ndërtues dhe synon në ndërtimin e shkollave të reja, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e disa shkollave ekzistuese po ashtu si dhe në dhënien e kontributit për ndërtimin me kapacitet të njësisë të ngarkuar me zbatimin. Ajo përbëhet nga komponentët e mëposhtëm :

(a) Vepra ndërtuese, që përfshijnë ndërtimin e dy shkollave të reja tetëvjeçare me 20 klasa të lokalizuara respektivisht në Qendrën veriore të Tiranës dhe Kamëz në zonën veriperendimore të Tiranës, si dhe rindërtimin e tre shkollave tetëvjeçare në periferitë e Tiranës dhe rehabilitimin e njëmbëdhjetë shkollave tetëvjeçare në zonat rrethuese të Tiranës, Durrësit dhe Kavajës.

(b) Mobilimi duke përfshirë mobiljet e lëvizshme dhe statike për gjithë nevojat e kërkuara administrative dhe akademike të shkollave;

(c) Pajisjet, në lidhje me furnizimin e pajisjeve të zyrës për administratën e shkollave, mësimdhënien shkencore, laboratorët e gjuhëve të huaja dhe shkencave si dhe sheshet sportive dhe të lojrave.

(d) Projektimi dhe mbikëqyrja, ku konsiston angazhimi i konsulentëve për të dhënë shërbime në lidhje me inxhinierinë e ndërtimit dhe strukturës, arkitekturës, inxhinierisë mekanike dhe elektrike, mbikëqyrja e sasive së bashku me projektin dhe supervizionin e ndërtimit të shkollave.

(e) Asistenca teknike, ku përfshihen shërbimet e një arkitekti të specializuar në projektimin e shkollave si dhe një inxhinier ndërtimi për të mbështetur njësinë e zbatimit të projektit (PIU) në kryerjen e detyrave të menaxhimit dhe supervizorit; dhe

(f) Njësia e zbatimit të projektit mbështetet, duke përfshirë mbulimin e shpenzimeve operative të PIU-së dhe të tjera shpenzime, ku përfshihen shpërblimi i stafit, prokurimi i një makine katër rrotëshe, pajisje dhe mobilje zyre, duke u shtrirë tek kompjuterat si dhe tek periferikët.

AFATI 2 AKORDIMI I HUASË

1. Vetëm nëse bihet dakort ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Drejtorisë së Fondit, tabela më poshtë deklaron komponentët që do të financohen nga të ardhurat e huasë, akordimi i shumave të Huasë për secilin komponent dhe përqindja e shpenzimeve totale për zërat që kështu do të financohen përsa i përket secilit komponent:

| Komponenti | Shuma e huasë akorduar (Shprehur në dollarë US) | Përqindja e shpenzimeve totale të financuara |
|-----------------------------|--|---|
| a) Vepra ndërtimi | 3.280.000 | 87 |
| b) Mobilje | 670.000 | 100 |
| c) Pajisje | 90.000 | 100 |
| d) Projektim dhe Mbikëqyrje | 180.000 | 100 |
| e) Asistence Teknike | 140.000 | 100 |
| f) Mbështetja PIU | 140.000 | 100 |
| Totali | 4.500.000 | |

2) Pavarësisht nga akordimi i një shume të huasë ose të përqindjeve të pagesave të paraqitura në tabelën në paragrafin 1 të mësipërm, në qoftë se Drejtoria e Fondit ka vlerësuar të drejtë se shuma e huasë atëhere të akorduar tek ndonjë komponent do të jetë e pamjaftueshme të financojë përqindjen e pranuar të të gjitha shpenzimeve në atë komponent, Drejtoria e Fondit mundet, pas njoftimit të Huamarrësit: (i) të riakordojë tek ky komponent, në shkallën e kërkuar për të plotësuar mungesën e vlerësuar, të ardhurat e Huasë të cilat akordohen atëhere tek një komponent tjetër dhe e cila për mendimin e Drejtorisë së Fondit nuk nevojitet për të plotësuar shpenzime të

tjera; dhe (ii) nëse ky riakordim nuk mund të plotësojë plotësisht mungesën e vlerësuar, pakëson përqindjen e pagesës që është e aplikueshme për këto shpenzime me qëllim që tërheqjet e mëtejshme përsa i përket këtij komponenti mund të vazhdojnë deri sa të gjitha shpenzimet pastaj do të jenë kryer.

AFATI 3
AFATI I AMORTIZIMIT

| Data e rikthimit | Shuma e detyrueshme (E shprehur në Dollarë US) |
|-------------------------|---|
| 15 Janar 2005 | 187.500 |
| 15 Korrik 2005 | 187.500 |
| 15 Janar 2006 | 187.500 |
| 15 Korrik 2006 | 187.500 |
| 15 Janar 2007 | 187.500 |
| 15 Korrik 2007 | 187.500 |
| 15 Janar 2008 | 187.500 |
| 15 Korrik 2008 | 187.500 |
| 15 Janar 2009 | 187.500 |
| 15 Korrik 2009 | 187.500 |
| 15 Janar 2010 | 187.500 |
| 15 Korrik 2010 | 187.500 |
| 15 Janar 2011 | 187.500 |
| 15 Korrik 2011 | 187.500 |
| 15 Janar 2012 | 187.500 |
| 15 Korrik 2012 | 187.500 |
| 15 Janar 2013 | 187.500 |
| 15 Korrik 2013 | 187.500 |
| 15 Janar 2014 | 187.500 |
| 15 Korrik 2014 | 187.500 |
| 15 Janar 2015 | 187.500 |
| 15 Korrik 2015 | 187.500 |
| 15 Janar 2016 | 187.500 |
| 15 Korrik 2016 | 187.500 |
| Totali | 4.500.000 |

The OPEC Fund for International Development

IN EITNESS ëhere of the parties here to, acting through their duly authorized representatives, have caused this Agreement to be signed and delivered at Vienna in three copies in the English language, each considered an original and all to the same and one effect as of the day and year first above ëritten.

FOR THE BORROËER:

Name: H.E.Anastas Angjeli
Minister of Finance

FOR THE OPEC FUND FOR
INTERNATIONAL DEVELOPMENT
Name: H.E.Dr. Saleh Al-Omair

Address: Ministry of Finance
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tirana
Republic of Albania
Telefax: 00355 42 28494

Chairman of the Governing Board
Address: The OPEC Fund For International
Development:
P.O. Box 995
A-1011 Vienna
Austria
Cable: OPEC FUND
Telex : 131734 FUND A
Telefax: 5139238

L I G J
Nr. 8612, datë 17.5.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE NË SITUATË TË PARREGULLT, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT LIDHUR ME TË, SI DHE TË PROTOKOLLIT PËR ZBATIMIN E SAJ"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran për ripranimin e personave në situatë të parregullt, të memorandumit të mirëkuptimit lidhur me të, si dhe të protokollit për zbatimin e saj".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2638, datë 26.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KËSHILLI FEDERAL ZVICERAN

(të quajtura më poshtë Palë kontraktuese)

me qëllim lehtësimin, me një frymë bashkëpunimi dhe solidariteti, ripranimin e personave në kufi dhe lejimin e kalimit të tyre tranzit, kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1

Ripranimi i shtetasve të Palëve

Çdo Palë kontraktuese ripranon në territorin e saj, me kërkesë të Palës tjetër kontraktuese, çdo person që nuk përmbush kushtet e hyrjes ose të qëndrimit të zbatueshme në territorin e Palës kontraktuese kërkuese në rast se është provuar ose prezumohet të ketë shtetësinë e Palës kontraktuese të kërkuar.

Pala kontraktuese kërkuese e ripranon në të njëjtat kushte këtë person në rast se të dhënat e mëvonshme tregojnë se ai nuk ka pasur shtetësinë e Palës kontraktuese të kërkuar në çastin e daljes së tij nga territori i Palës kontraktuese kërkuese.

Në rast se personi ka shumë shtetësi ose zotëron një leje qëndrimi të përhershme, lëshuar nga një shtet i tretë, Palët kontraktuese nuk janë të detyruara ta ripranojnë në qoftë se ai mund të shkojë në këtë shtet të tretë.

Neni 2

Ripranimi i shtetasve të shteteve të treta

Neni i parë i kësaj Marrëveshjeje zbatohet për analogji edhe për shtetasit e shteteve të treta që zotërojnë një leje të përhershme qëndrimi të lëshuar në territorin e Palës kontraktuese të kërkuar, ose që, po në këtë territor i njihet statusi i refugjatit.

Pala kontraktuese kërkuese ripranon çdo person, i cili figuron në kategorinë e përcaktuar në paragrafin e parë, në rast se më vonë del se në çastin e daljes së tij nga territori i Palës kontraktuese të kërkuar, nuk zotëronte leje qëndrimi të përhershme ose statusi i refugjatit nuk i është dhënë në territorin e Palës kontraktuese të kërkuar.

Neni 3

Leja e qëndrimit të përhershëm

Konsiderohet si leje qëndrimi e përhershme në bazë të nenit 2 çdo leje e dhënë nga autoritetet kompetente të njëres ose tjetres Palë kontraktuese sipas legjislacionit të brendshëm të tyre dhe që figuron në listën që përmban protokollin i zbatimit.

Neni 4

Afatet

1. Pala kontraktuese e kërkuar duhet t'u përgjigjet me shkrim në një afat brenda pesëmbëdhjetë ditësh pune zyrtare, kërkesave të ripranimit që i janë paraqitur.

2. Pala kontraktuese e kërkuar duhet të ripranojë për një afat njëmuor, personin për të cilin ka miratuar ripranimin. Ky afat mund të zgjatet me kërkesë të Palës kontraktuese e kërkuese.

Në qoftë se vërtetohet se një i huaj ka qëndruar me dijeninë e një Pale kontraktuese, gjatë më shumë se një viti, pa ndërprerje, në territorin e kësaj Pale, kjo e fundit nuk mund të paraqesë për raste të tilla kërkesa për ripranim.

Neni 5

Pranimi i kalimit tranzit

1. Secila palë kontraktuese ka për detyrë, me kërkesë të Palës tjetër kontraktuese, të pranojë kalimin tranzit të shtetasve të shteteve të treta, me kusht që vazhdimi i udhëtimit në shtetet nga do të kalohet dhe ripranimi nga shteti i mbërritjes të garantohet nga Pala kontraktuese kërkuese. Në një rast të tillë nuk është e nevojshme viza tranzit e vendosur nga pala kontraktuese kërkuar.

2. Pranimi i kalimit tranzit të personave të përmendur në paragrafin 1 nuk do të kërkohet ose do të refuzohet kur ekzistojnë tregues të mjaftueshëm, që provojnë se personi rrezikon të pësojë trajtime çnjerëzore apo dënim me vdekje në shtetin e mbërritjes ose në një shtet eventual tranzit, apo

kur jeta, integriteti i tij fizik ose liria e tij kërcënohen për arsye kombësie, feje, race apo bindjesh politike.

3. Gjithashtu, pranimi i kalimit tranzit mund të refuzohet në rast se për personin mund të parashikohet që në territorin e Palës kontraktuese të kërkuar, në territorin e shtetit tranzit apo në shtetin e mbërritjes, një ndjekje penale apo ekzekutim dënimi, duke përfshirë këtu një sanksion për kalim të paligjshëm të kufirit.

4. Kërkesa për pranim të kalimit tranzit duhet të paraqitet me shkrim dhe të trajtohet drejtpërdrejt midis Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Drejtësisë dhe Policisë së Konfederatës Zvicerane. Forma dhe përmbajtja e kërkesës përcaktohen në protokollin e zbatimit.

5. Nëse kushtet e përmendura në paragrafët 1 deri më 3 plotësohen dhe Pala kontraktuese e kërkuar refuzon për këtë arsye kërkesën për kalim tranzit, ajo duhet t'i paraqesë me shkrim Palës kontraktuese kërkuese arsyet e refuzimit. Edhe pas dhënies së lejes, personat që kalojnë tranzit mund t'i dorëzohen Palës kontraktuese kërkuese në rast se më vonë rezulton se kushtet e përmendura në paragrafin e parë nuk përmbushen ose kur ekzistojnë arsye refuzimi në bazë të paragrafit 2 dhe 3.

Në këto raste, Pala kontraktuese kërkuese është e detyruar të ripranojë me shpenzimet e saj personin përkatës.

Neni 6 Mbrojtja e të dhënave

1. Në rast se transmetimi i të dhënave personale kërkohet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, këto informacione duhet të kenë të bëjnë ekskluzivisht:

- me të dhënat personale lidhur me personin që do të dorëzohet dhe, në rast nevojë, ato të anëtarëve të familjes (emrin, mbiemrin dhe në rast se duhet emrin eventuale të mëparshëm, pseudonimin, datën dhe vendin e lindjes, seksin, shtetësinë aktuale dhe atë eventuale të mëparshme),
- me kartën e identitetit ose pasaportën (numrin, kohëzgjatjen e vlefshmërisë, datën, autoritetin dhe vendin e lëshimit),
- me të dhëna të tjera të domosdoshme për identifikimin e personit që do të dorëzohet, vendet e qëndrimit dhe itineraret,
- me lejet e qëndrimit ose vizat e lëshuara nga njëra Palë apo tjetra prej Palëve kontraktuese.

2. Në këtë kontekst:

a) Pala kontraktuese e kërkuar përdor të dhënat personale të transmetuara me qëllimin e parashikuar nga Marrëveshja.

b) Secila nga Palët kontraktuese informon Palën tjetër kontraktuese, me kërkesë të kësaj të fundit, për përdorimin e të dhënave personale të transmetuara dhe për rezultatet e arritura.

c) Të dhënat personale mund të trajtohen vetëm nga autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Çdo transmetim i mëtejshëm i autoriteteve të tjera duhet të ketë paraprakisht autorizimin e autoritetit, që i ka transmetuar ato.

d) Pala kontraktuese që transmeton të dhënat është e detyruar të garantojë saktësinë e tyre dhe nevojën e përdorimit të tyre vetëm në përshtatje me qëllimin e transmetimit të tyre. Pavarësisht nga kjo ka arsye për të konsideruar kufizime të transmetimit sipas së drejtës të brendshme të secilës Palë. Nëse vërtetohet se të dhëna të pasakta janë transmetuar ose nëse transmetimi ishte i paligjshëm, pala marrëse duhet të lajmërohet menjëherë. Duhet të procedohet me korigjimin ose shkatërrimin e të dhënave në fjalë.

e) Me kërkesën e tij, personi i interesuar do të informohet mbi informacionet që ekzistojnë mbi të dhe për mënyrën se si do të përdoren ato. Nuk ekziston detyrimi i informimit nëse duket se interesi publik për të mos dhënë informacion është dominues në raport me atë të personit të interesuar për t'u informuar.

f) Nga ana tjetër e drejta e personit të interesuar për të pasur informacion mbi të dhënat që kanë të bëjnë me të personalisht varet nga e drejta e brendshme e Palës kontraktuese në territorin e të cilës kërkohet informacioni.

g) Të dyja Palët kontraktuese janë të detyruara të regjistrojnë në dosjet e tyre të transmetimit dhe të marrjes të dhënat personale.

h) Të dyja Palët kontraktuese janë të detyruara të mbrojnë me efikasitet të dhënat personale të transmetuara kundër shfrytëzimit të paautorizuar, përdorimin e tyre abuziv dhe transmetimin e paligjshëm. Në të gjitha rastet të dhënat e transmetuara përfitojnë të paktën mbrojtjen të cilën gëzojnë, të dhënat e të njëjtit lloj, sipas legjislacionit të Palës kontraktuese kërkuese.

Neni 7 **Shpenzimet**

1. Shpenzimet e verifikimeve lidhur me shtetësinë, si dhe shpenzimet e dhënies së dokumenteve të udhëtimit shtesë, janë në ngarkim të Palës kontraktuese kërkuese.

2. Pala kontraktuese kërkuese përballon, deri në kufirin e Palës kontraktuese të kërkuar, shpenzimet e transportit të personave dhe u jep atyre një shumë për të garantuar kthimin e tyre në destinacionin e mbërritjes.

3. Pala kontraktuese kërkuese përballon shpenzimet e transportit tranzit deri në kufirin e shtetit të mbërritjes dhe në rast nevojë edhe shpenzimet e udhëtimit të kthimit.

Neni 8 **Zbatimi i marrëveshjes**

Ministria e Rendit Publik e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Policisë së Konfederatës së Zvicrës nënshkruajnë një protokoll zbatimi të kësaj Marrëveshjeje. Ky protokoll përcakton:

a. shërbimet zyrtare kompetente dhe mënyrat e procedurës për informimin e dyanshëm, si dhe për dorëzim e ripranim;

b. dokumentet dhe informacionet e nevojshme për dorëzim dhe ripranim;

c. si dhe mënyrat e rregullimit financiar sipas nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9 **Klauzola e paprekshmërisë**

Kjo Marrëveshje nuk prek detyrimet e Palëve kontraktuese që kanë të bëjnë:

- me zbatimin e Konventës së 28 korrikut 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve, në versionin e saj të Protokollit të 31 janarit 1967, mbi statusin e refugjatëve;

- me zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve të nënshkruara nga palët në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

Traktatet ndërkombëtare mbi ekstradimin nuk preken nga kjo Marrëveshje.

Neni 10 **Parimi i bashkëpunimit të mirë**

1. Palët kontraktuese angazhohen të bashkëpunojnë ngushtë dhe të zgjidhin, duke u marrë vesh së bashku, problemet që mund të paraqiten gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Ato informojnë rregullisht njëra-tjetrën për kushtet që ato shtrojnë për hyrjen në territorin e tyre të shtetasve të një shteti të tretë.

2. Në rast nevojë çdo Palë kontraktuese mund të kërkojë thirrjen e menjëhershme të një mbledhjeje ekspertësh për të zgjidhur çështjet lidhur me realizimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë, pas ditës së marrjes të njoftimit

të dytë me shkrim, me anë të cilit Palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave kushtetuese përkatëse.

Neni 12
Pezullimi

Çdo Palë kontraktuese mund të pezullojë përkohësisht të gjithë ose pjesë të nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje, për arsye që lidhen me rendin publik, sigurinë, shëndetin publik. Pezullimi dhe heqja e tyre duhet t'i komunikohet menjëherë Palës tjetër kontraktuese me shkrim dhe nëpërmjet rrugës diplomatike.

Neni 13
Denoncimi

Kjo Marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Ajo mund të denoncohet me rrugë diplomatike me një njoftim paraprak prej 30 ditësh.

Bërë në _____, më ___/___/2000.

Në dy kopje origjinale, të hartuara në gjuhën shqipe dhe frënge.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Spartak Poçi
Ministër i Rendit Publik

PËR KËSHILLIN
FEDERAL ZVICERAN

Ruth Metzler-Arnold
Shefe e Departamentit
Federal të Drejtësisë dhe Policisë

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ministria e Rendit Publik e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti Federal i Drejtësisë dhe Policisë së Konfederatës Zvicerane,

duke iu referuar Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran lidhur me ripranimin e personave në situatë të parregullt (Marrëveshja e Ripranimit) dhe Protokollin i saj, nënshkruar në Berne më 29 shkurt 2000,

Ranë dakord si më poshtë:

Shprehja “shtetas të vendeve të treta” që figuron në nenin 5 të Marrëveshjes së sipërpërmendur do të kuptohet dhe do të aplikohet vetëm për shtetasit jugosllavë me origjinë shqiptare.

Palët kontraktuese angazhohen, me kërkesë të njëres prej tyre ose në rastet e ndryshimit të kushteve, të bëjnë konsultime lidhur me nenin 5 të marrëveshjes së sipërpërmendur.

Duke marrë në konsideratë çka u tha më sipër, dy Palët kontraktuese nënshkruan këtë Memorandum Mirëkuptimi, në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën frënge, të dyja në të njëjtën vlerë.

Bërë në Bernë, më 29.2.2000.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Spartak Poçi
Ministër i Rendit Publik

PËR KËSHILLIN
FEDERAL ZVICERAN

Ruth Matzler-Arnold
Shefe e Departamentit Federal
të Drejtësisë dhe Policisë

PROTOKOLL ZBATIMI

I MARRËVESHJES MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE NË SITUATË TË PARREGULLT

Ministria e Rendit Publik e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Policisë së Konfederatës Zvicerane (të quajtura më poshtë “palë kontraktuese”), me qëllim që të zbatohet Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran mbi ripranimin e personave në situatë të parregullt (e quajtur më poshtë thjesht “Marrëveshje”), kanë rënë dakord si më poshtë në bazë të nenit 8 të Marrëveshjes:

1. Lidhur me nenin 1 dhe 10 të Marrëveshjes:

1.1. Prova e shtetësisë paraqitet me anë të dokumenteve të mëposhtme:

a) për shtetësinë shqiptare:

- pasaportë të shtetësisë shqiptare, e vlefshme.
- kartë identiteti.
- certifikatë lindje me fotografi.
- patentë
- librezë ushtarake.

b) për shtetësinë zvicerane:

- kartë identiteti e vlefshme;
- dokument që shërben si pasaportë, me fotografi;
- pasaporta të vlefshme të të gjitha llojeve.
- Librezë ushtarake.

Me paraqitjen e këtyre dokumenteve Palët kontraktuese pranojnë që prova e shtetësisë vërtetohet pa qenë nevoja për kontrolle të tjera.

1.2. Prezumimi i shtetësisë konsiderohet i kryer me anë të:

a) për shtetësinë shqiptare:

- çdo dokumenti edhe i skaduar, në bazë të pikës 1.1 të këtij protokolli;
- certifikatë lindje
- deklaratë dëshmitarësh;
- të dhëna të ofruara nga personi i interesuar;
- gjuha e folur nga personi i interesuar.

b) për shtetësinë zvicerane:

- çdo dokumenti, qoftë edhe i skaduar, në bazë të pikës 1.1 të këtij protokolli;
- dokumente personale që vërtetojnë përkatësinë në ushtrinë zvicerane;
- karta identiteti;
- patenta;
- certifikatë lindje;
- deklaratë dëshmitarësh;
- të dhëna të ofruara nga personi i interesuar;
- gjuha e folur nga personi i interesuar.

Në këto raste shtetësia konsiderohet e provuar nga Palët kontraktuese për aq kohë sa pala kontraktuese e kërkuar nuk e ka refuzuar këtë brenda një afati prej 15 ditësh pune zyrtare.

1.3. Kur pala kontraktuese kërkuuese mendon se shtetësia është prezumuar në bazë të pikës 1.2 të këtij protokolli, ajo i komunikon me shkrim palës kontraktuese të kërkuar të dhënat e mëposhtme të personit të interesuar:

- a) emri dhe mbiemri, eventualisht për gratë, mbiemri i vajzërisë;
- b) datëlindja dhe vendlindja;
- c) adresën e banimit më të fundit të njohur në shtetin e origjinës;
- d) fotokopje të dokumenteve ku bazohet prezumimi i shtetësisë ose i identitetit.

Përgjigjja i transmetohet menjëherë dhe me shkrim Palës kontraktuese kërkuuese.

1.4. Nëse personi i interesuar duhet t'i nënshtrohet kujdesit mjekësor, pala kontraktuese

kërkuese i transmeton gjithashtu një përshkrim të gjendjes shëndetësore dhe do ta njoftojë nëse personi ka nevojë për një trajtim të veçantë si p.sh. ndihmë mjekësore ose tjetër, mbikëqyrje ose transport me ambulancë (eventualisht jepet edhe epikrizë).

1.5. Përfaqësia jashtë shtetit e Palës kontraktuese të kërkuar mbështet Palën kontraktuese kërkuese për verifikimin e shtetësisë, në veçanti për dëgjime të përbashkëta të personave që duhet të largohen nga territori.

2. Lidhur me nenet 2 dhe 3 të Marrëveshjes;

2.1. Në bazë të nenit 2 të Marrëveshjes, ripranimi bëhet me kërkesë me shkrim të Palës kontraktuese kërkuese. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emër e mbiemër, eventalisht për gratë edhe mbiemrin e vajzërisë;
b) datëlindjen dhe vendlindjen;
c) shtetësinë;
d) adresën e fundit të banimit të njohur në shtetin kontraktues të kërkuar;
e) lloji, numri i serisë, kohëzgjatja e vlefshmërisë e pasaportës ose e dokumenteve të tjerë të udhëtimit si dhe përmendjen e autoritetit lëshues të tyre duke i bashkëngjitur një fotokopje të dokumentit të udhëtimit.

2.2. Prova e qëndrimit të përhershëm vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:

a) në territorin e Republikës së Shqipërisë:
- Dokument refugjati lëshuar në bazë të Konventës të 28 korrikut 1951 lidhur me statusin e refugjatëve (dokument udhëtimi për refugjatë me status).

b) në territorin e Konfederatës Zvicerane:
- Leje e vlefshme C për të huajt, lëshuar një të huaji të vendosur në Zvicër nga një polici kantonale për të huajt;

- Dokument udhëtimi i vlefshëm për refugjatët në bazë të Konventës së 28 korrikut 1951 lidhur me statusin e refugjatëve (dokument udhëtimi për refugjatë me status);

- pasaportë e vlefshme për të jashtë shtetit.

3. Pika 1.2 e këtij Protokollit zbatohet për analogji edhe për prezumimin e qëndrimit të përhershëm. Në këto raste ripranimi bëhet vetëm me miratimin e posaçëm të Palës kontraktuese të kërkuar. Kjo e fundit i përgjigjet kërkesës brenda 15 ditësh pune zyrtare.

Lidhur me nenet nga 1 dhe 2;

Në rast të pranimit të kërkesës së ripranimit, përfaqësia jashtë shtetit e Palës kontraktuese të kërkuar jep pa afat një dokument udhëtimi për kthim.

4. Për nenet 1 deri në 3:

4.1. Autoritetet e mëposhtme janë kompetente për të paraqitur, pranuar dhe trajtuar kërkesat e ripranimit:

a) për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Rendit Publik

Drejtoria e Policisë së Rendit

Adresa postare: Sheshi Skënderbej nr.3, Tiranë, Shqipëri.

Fax: 00 355 42 283 17

Tel: 00 355 42 643 61

b) për Konfederatën Zvicerane:

Departamenti Federal i Drejtësisë dhe Policisë

Zyra Federale e Refugjatëve (ODR)

Adresa postare: Quellenëeg 6, CH-3003 Berne-Äabern

Fax: 0041 31 325 91 04

Tel: 0041 31 325 92 70

4.2. Personat mund të ripranohen në pikat e kalimit kufitar të mëposhtëm:

- a) për Republikën e Shqipërisë:
 - Tiranë, Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit.
- b) për Konfederatën Zvicerane:
 - Zyrih, Aeroporti Ndërkombëtar i Kloten
 - Gjenevë, Aeroporti Ndërkombëtar i Cointrin.

5. Lidhur me nenin 4 të Marrëveshjes:

Afatet në bazë të nenit 4 janë afate maksimale. Afati fillon që me njoftimin e kërkesës së ripranimit Palës kontraktuese të kërkuar.

6. Lidhur me nenin 5 të Marrëveshjes:

6.1. Autoritetet e mëposhtme janë kompetente për paraqitjen, marrjen dhe trajtimin e kërkesave të pranimit të kalimit tranzit;

a) për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Rendit Publik

Drejtoria e Policisë së Rendit

Adresa postare: Sheshi Skënderbej nr.3, Tiranë, Shqipëri

Fax: 00 355 42 283 17

Tel: 00 355 42 643 61

b) për Konfederatën Zvicerane:

Departamenti Federal i Drejtësisë dhe Policisë

Zyra Federale e Refugjatëve (ODR)

Adresa postare: Quellenëeg 6, CH-3003 Bernë-Ëarbern

Fax: 0041 31 325 91 04

Tel: 0041 31 325 92 70

6.2. Kërkesa e ripranimit të kalimit tranzit duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për personin e interesuar:

- a) emri dhe mbiemri, eventualisht mbiemri i vajzërisë për gratë;
- b) datëlindja dhe vendlindja;
- c) shtetësia;
- d) adresa e banimit më e fundit e njohur në vendin e mbërritjes;
- e) lloji, numri i serisë, kohëzgjatja e vlefshmërisë së pasaportës ose dokumenteve të tjerë të udhëtimit, si dhe autoriteti lëshues, duke i bashkëngjitur fotokopjen e dokumenteve të udhëtimit.

6.3. Kërkesa e ripranimit të kalimit tranzit duhet të përmendë nëse duhet të parashikohen masa sigurie të veçanta, asistencë mjekësore ose tjetër për personin e interesuar.

6.4. Kërkesa e ripranimit në tranzit duhet të paraqitet me shkrim. Pala kontraktuese e kërkuar përgjigjet me shkrim brenda dhjetë ditësh pune zyrtare nga data e marrjes së kërkesës.

6.5. Nëse pala kontraktuese e kërkuar pranon një kërkesë, pranimi i kalimit tranzit duhet të kryhet brenda 30 ditësh pas datës së marrjes së kërkesës.

6.6. Për kohën e saktë, si dhe mënyrat e dorëzimit e të pranimit në kalim tranzit (nr. i fluturimit, ora e nisjes dhe e mbërritjes, të dhënat personale lidhur me shoqërues eventualë) autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese bien dakord drejtpërdrejt. Nëse pranimi i kalimit tranzit në shtetin kontraktues të kërkuar duhet të bëhet në rrugë tokësore, mund të propozohen maksimalisht 30 persona për çdo transport.

7. Lidhur me nenin 7 të Marrëveshjes:

7.1. Brenda 30 ditësh nga marrja e faturës, pala kontraktuese kërkuese duhet të paguajë shpenzimet sipas nenit 7 të Marrëveshjes duke xhiruar shumën në franga zvicerane në llogarinë bankare të Ministrisë ose të Departamentit të Palës tjetër kontraktuese. Palët kontraktuese i

komunikojnë njëra-tjetrës adresat bankare nëpërmjet shkëmbimit të notave verbale.

7.2, Palët kontraktuese përpiqen të zbatojnë ripranimin në kalim tranzit në mënyrën më racionale dhe më ekonomike të mundshme, duke mbajtur gjithashtu parasysh prioritetet e sigurisë.

7.3, Palët kontraktuese autorizojnë shefat e organeve të tyre financiare kompetente për t'u marrë vesh çdo vit për shpenzimet dhe tarifat që mund të faturohen.

8. Organet kompetente të palëve kontraktuese përdorin, përjashtuar rastet e konventave të papajtueshme, gjuhën frënge ose angleze për zbatimin e Marrëveshjes dhe të këtij Protokollit.

9. Autoritetet nënshkruese mund të modifikojnë protokollin me anë të shkëmbimit të notave verbale.

10. Ky protokoll hyn në fuqi në të njëjtën kohë me Marrëveshjen.

Bërë në _____, më ___/___/2000, në dy tekste origjinale të përpiluara në shqip dhe në frëngjisht.

PËR MINISTRINË E RENDIT PUBLIK
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Spartak Poçi
Ministër i Rendit Publik

PËR DEPARTAMENTIN E
E DREJTËSISË DHE POLICISË
TË KONFEDERATËS ZVICERANE

Ruth Metzler-Arnold
Shefe e Departamentit Federal
të Drejtësisë dhe Policisë

DEKRET
Nr. 2628, datë 22.5.2000

PËR LIRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 98, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit Ilir Meta,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zonja Ingrid Shuli, me kërkesën e saj, lirohet nga detyra e Ministrit të Transportit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

DEKRET
Nr. 2629, datë 22.5.2000

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 98, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit Ilir Meta,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Sokol Nako emërohet Ministër i Transportit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 162, datë 13.4.2000

PËR SHPËRNDARJEN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË SHOQËRISË
“UNIVERSI”, SH.P.K. NË ADMINISTRIM, PËR MBYLLJEN E PROCESIT TË
ADMINISTRIMIT DHE PËR KALIMIN E DOKUMENTACIONIT FINANCIAR ORGANIT
TË HETIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 6, të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe të neneve 3, 4 e 8, pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë“, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I:

1. Fillimin e procesit të shpërndarjes së vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi”, sh.p.k. në administrim, në bazë të të ardhurave financiare, të grumbulluara nga shitja e aseteve në ankandin publik.

2. Shuma e detyrimit të mbetur që shoqëria “Universi” sh.p.k., në administrim ka ndaj kreditorëve është 242 469 153 lekë.

Të ardhurat financiare për shpërndarje, të grumbulluara nga shitja e aseteve dhe ato gjendje të depozituara në bankë kapin shumën 96 000 000 lekë.

Koeficienti i kthimit të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, për të gjithë kreditorët është: 0.40 ose 40 për qind.

3. Ngarkohet Banka e Kursimeve me shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi” sh.p.k., në administrim.

Shpenzimet për shërbimet që do të kryhen në sportelet e bankës së Kursimeve të përballohen nga zëri “Shpenzime” në buxhetin për vitin 2000 të Grupit të Mbikëqyrjes.

4. Dokumentacioni i ekspertimit kontabël dhe i administrimit të shoqërisë “Univers” sh.p.k. në administrim, t’i dorëzohet organit të hetimit.

5. Ngarkohen Banka e Kursimeve, Grupi i Mbikëqyrjes dhe administratori i shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr. 172, datë 13.4.2000

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-MAMINAS (KM 1.6-2.7) PJESË E SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, “Për shpronësimin për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, tokë bujqësore 76520 m², truall 2467 m², që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Maminas (km 1.6-2.7), në territorin e bashkisë së Vorës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen me lekë, në vlerë të plotë, sipas listës emërore dhe sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqiten në tabelën që i bashkëlidhen këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 90 323 407 (nëntëdhjetë milionë e treqindnjëzet e tre mijë e katërqindeshtatë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt në buxhetin e vitit 2000 të Ministrisë së Transportit, në zërin “Shpronësime”.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 2000.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, këshilli i rrethit të Tiranës, bashkia e Vorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

Bashkia Vorë
Fshati Kodër-Vorë

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-17)

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip (m ²) | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Vlera e kulturave | Totali në lekë |
|-----|----------|---------|---------------|----------|-----------|----------|----------|-----------------------|------------------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| 1. | Baftjar | Ramadan | Adushi | 175 | 103/1 | 57 | 11,5 | 655,5 | 1100 | 721050 | 0 | 721050 |
| 2. | Ismail | Xhemal | Gjoka | 232 | 103/10 | 5 | 17 | 85 | 1100 | 93500 | 0 | 93500 |
| 3. | Kadri | Mustafa | Gjoka | 237 | 103/10 | 17,2 | 19 | 326,8 | 1100 | 359480 | 8170 | 367650 |
| 4. | Ismail | Xhemal | Gjoka | 254,2 | 103/8 | 17,2 | 24,5 | 421,4 | 1100 | 463540 | 10535 | 474075 |
| 5. | Xhelal | Mustafa | Gjoka | 271,4 | 102/9 | 17,2 | 29,5 | 507,4 | 1100 | 558140 | 12685 | 570825 |
| 6. | Muhamet | Mustafa | Gjoka | 288,6 | 103/7 | 17,2 | 34,5 | 593,4 | 1100 | 652740 | 14835 | 667575 |
| 7. | Haxhi | Arif | Maloku | 305,8 | 103/17 | 14 | 41 | 574 | 1100 | 631400 | 14350 | 645750 |
| 8. | Beqir | Arif | Gjoka | 319,8 | 103/16 | 14 | 42,5 | 595 | 1100 | 654500 | 14875 | 669375 |
| 9. | Bajram | Arif | Gjoka | 333,8 | 103/12 | 14 | 45 | 630 | 1100 | 693000 | 15750 | 708750 |
| 10. | Qazim | Arif | Gjoka | 347,8 | 103/13 | 14 | 45,5 | 637 | 1100 | 700700 | 15925 | 716625 |
| 11. | Luftulla | Ramazan | Subashi | 361,8 | 103/1 | 24 | 43 | 1032 | 1100 | 1135200 | 0 | 1135200 |
| 12. | Luftulla | Ramazan | Subashi | 385,8 | 103/1 | 24 | 89,3 | 2142 | 1100 | 2356728 | 0 | 2356728 |
| 13. | Shaban | Vath | Maloku | 475 | 102/7 | 10 | 66,5 | 665 | 1100 | 731500 | 16625 | 748125 |
| 14. | Sami | Avdyl | Gjoka | 505 | 102/3 | 5 | 29 | 145 | 1100 | 159500 | 2900 | 162400 |
| 15. | Rruzhdin | Riza | Gjoka | 510 | 102/4 | 5 | 30 | 150 | 1100 | 165000 | 0 | 165000 |
| 16. | Sami | Avdyl | Gjoka | 495 | 102/3 | 20 | 26 | 520 | 1100 | 572000 | 0 | 572000 |
| 17. | Islam | Vath | Gjoka | 515 | 102/3 | 10 | 54 | 540 | 1100 | 594000 | 8100 | 602100 |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | Shuma: | | | | | 10220 | | 11241978 | 134750 | 11376728 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

Bashkia Vorë
Fshati Muçaj

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-8)

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip (m ²) | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Vlera e kulturave | Totali në lekë |
|---------------|---------|--------|---------|----------|-----------|----------|----------|-----------------------|------------------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| 1. | Adrian | Elez | Muça | 428,4 | 89 | 20 | 67 | 1340 | 1100 | 1474000 | 0 | 1474000 |
| 2. | Enver | Sadik | Muça | 448,4 | 89 | 61 | 58 | 3538 | 1100 | 3891800 | 0 | 3891800 |
| 3. | Qazim | Sadik | Muça | 509,4 | 89 | 61 | 57 | 3477 | 1100 | 3824700 | 35400 | 3860100 |
| 4. | Xhemal | Hamdi | Muça | 570,4 | 89 | 42,5 | 55,5 | 2359 | 1100 | 2594625 | 0 | 2594625 |
| 5. | Pellumb | Hamdi | Muça | 625,9 | 89 | 42,5 | 55,5 | 2359 | 1100 | 2594625 | 0 | 2594625 |
| 6. | Bujar | Hamdi | Muça | 668,4 | 89 | 42,5 | 55,5 | 2359 | 1100 | 2594625 | 0 | 2594625 |
| 7. | Shefçet | Zenel | Muça | 710,9 | 89 | 33 | 53 | 1749 | 1100 | 1923900 | 0 | 1923900 |
| 8. | Osman | Ismail | Muça | 743,9 | 89 | 164 | 48 | 7872 | 1100 | 8659200 | 0 | 8659200 |
| Shuma: | | | | | | | | 25052 | | 27557475 | 35400 | 27592875 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

Bashkia Vorë
Fshati Kodër-Vorë Muçaj

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-11)

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip (m ²) | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Vlera e kulturave | Totali në lekë |
|---------------|----------|---------|---------|----------|-----------|----------|----------|-----------------------|------------------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| 1. | Muharrem | Vath | Gjoka | 525 | 102 | 10 | 51 | 510 | 1100 | 561000 | 10200 | 571200 |
| 2. | Baki | Rrahman | Gjoka | 535 | 101 | 30 | 43 | 1290 | 1100 | 1419000 | 0 | 1419000 |
| 3. | Petrit | Shaban | Gjoka | 595 | 101 | 61 | 25,5 | 1556 | 1100 | 1711050 | 0 | 1711050 |
| 4. | Skënder | Mersin | Gjoka | 656 | 101 | 20 | 21 | 420 | 1100 | 462000 | 0 | 462000 |
| 5. | Demir | Mersin | Maloku | 676 | 101 | 20 | 21 | 420 | 1100 | 462000 | 0 | 462000 |
| 6. | Muhamet | Nuredin | Gjoka | 696 | 101 | 20 | 21 | 420 | 1100 | 462000 | 0 | 462000 |
| 7. | Bulin | Xhemal | Muça | 300 | 89 | 14,5 | 46 | 667 | 1100 | 733700 | 0 | 733700 |
| 8. | Kalem | Xhemal | Muça | 314,5 | 89 | 11,3 | 49 | 553,7 | 1100 | 609070 | 11740 | 620810 |
| 9. | Fadil | Xhemal | Muça | 325,8 | 89 | 11,3 | 52 | 587,6 | 1100 | 646360 | 0 | 646360 |
| 10. | Shaqir | Xhemal | Muça | 337,1 | 89 | 11,3 | 55 | 621,5 | 1100 | 683650 | 0 | 683650 |
| 11. | Vath | Rap | Muça | 348,4 | 89 | 40 | 62 | 2480 | 1100 | 2728000 | 37200 | 2765200 |
| Shuma: | | | | | | | | 9525 | | 10477830 | 59140 | 10536970 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

Bashkia Vorë
Fshati Marqinet

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-2)

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip (m ²) | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Vlera e kulturave | Totali në lekë |
|-----|-------|--------|---------------|----------|-----------|----------|----------|-----------------------|------------------------------|----------------|-------------------|----------------|
| 1. | Ismet | Shaqir | Picari | 1295 | 38 | 106 | 47 | 4982 | 1100 | 5480200 | 0 | 5480200 |
| 2. | Ismet | Shaqir | Picari | 1261 | 38 | 34 | 35,8 | 1217 | 1100 | 1338920 | 0 | 1338920 |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | Shuma: | | | | | 6199 | | 6819120 | 0 | 6819120 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

Bashkia Vorë
Fshati Marqinet

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-20)

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip (m ²) | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Vlera e kulturave | Totali në lekë |
|-----|---------------|------------|---------|---------------|-----------|----------|----------|-----------------------|------------------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| 1. | Halit Osman | Rramollari | | 1942,5 | 36 | 12 | 83 | 996 | 1100 | 1095000 | 0 | 1095000 |
| 2. | Mustafa Idriz | Ismaili | | 1892,6 | 36 | 49,9 | 35,32 | 1762,47 | 1100 | 1938714,8 | 0 | 1938714,8 |
| 3. | Qazim Ali | Ismaili | | 1873,5 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 4. | Sabah Ali | Ismaili | | 1854,4 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 5. | Beqir Ali | Ismaili | | 1835,3 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 6. | Fatbardha | Hamdi | Ismaili | 1816,2 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 7. | Bujar Ali | Ismaili | | 1797,09 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 8. | Rexhep Islam | Ismaili | | 1778 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 9. | Sherif Islam | Ismaili | | 1758,9 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 10. | Petrit Islam | Ismaili | | 1739,8 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 11. | Lule Osman | Ismaili | | 1720,7 | 36 | 19,1 | 45,5 | 869,05 | 1100 | 955955 | 0 | 955955 |
| 12. | Besim Islam | Ismaili | | 1698,5 | 36 | 22,19 | 39,16 | 868,96 | 1100 | 955856,44 | 0 | 955900 |
| 13. | Xhemali Hamza | Ismaili | | 1654,7 | 37 | 44,7 | 45 | 2010 | 1100 | 2211000 | 0 | 2211000 |
| 14. | Adem Hamit | Alvora | | 1633,7 | 37 | 21 | 46 | 966 | 1100 | 1062600 | 0 | 1062600 |
| 15. | Arben Dalip | Haxhiu | | 1612,7 | 37 | 21 | 49 | 1029 | 1100 | 1131900 | 0 | 1131900 |
| 16. | Mustafa Idriz | Ismaili | | 1551,2 | 37 | 19,5 | 44 | 858 | 1100 | 943800 | 0 | 943800 |
| 17. | Hamdi Hysen | Alvora | | 1531,7 | 37 | 19,5 | 44 | 858 | 1100 | 943800 | 0 | 943800 |
| 18. | Arben Dalip | Haxhiu | | 1489,7 | 37 | 42 | 46 | 1932 | 1100 | 2125200 | 0 | 2125200 |
| 19. | Mustafa Idriz | Ismaili | | 1400,7 | 37 | 82 | 48 | 3936 | 1100 | 4329600 | 0 | 4329600 |
| 20. | Agron Kalem | Picari | | 1570,7 | 37 | 42 | 46 | 1932 | 1100 | 2125200 | 0 | 2125200 |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | Shuma: | | | | 24970 | | 27466866 | 0 | 27466415 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

LISTAT E RISHIKUARA

Bashkia Vorë
Fshati Marqinet

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-3)

| | 1 | | | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|-----|---------------|--------|---------|----------|-----------|----------|----------|-----------------------|------------------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip (m ²) | Çmimi në lekë/m ² | Vlera në lekë | Vlera e kulturave | Totali në lekë |
| 1. | Imer | Sefer | Previzi | 3151,1 | 25 | 3,61 | 37,2 | 134,292 | 1100 | 147721,2 | 0 | 147721,2 |
| 2. | Fatos | Ruzhdi | Picari | | 243 | 23,64 | 5,5 | 130,02 | 1100 | 143022 | 0 | 143022 |
| 3. | Arif | Murat | Mukci | 2701 | 25 | 3,63 | 80 | 290,4 | 1100 | 319440 | | 319440 |
| | | | | | | | | | | | | |
| | Shuma: | | | | | | | 554,712 | | 610183,2 | 0 | 610183,2 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

LISTAT E REDUKTUARA

Bashkia Vorë
Fshati Vorë

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Truall nr.(1-7)

| | 1 | | | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
|-----|---------------|---------|----------|----------|-----------|----------|----------|----------------------------------|--------------------------------------|-----------------------|
| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pikë | Nr. Parc. | Gjat (m) | Gjer (m) | Sip e truallit (m ²) | Çmimi i truallit lekë/m ² | Vlera e truallit lekë |
| 1. | Fiqiri | Kadri | Ismaili | 723 | 90/2 | 19 | 28 | 532 | 2400 | 1276800 |
| 2. | Luan | Kamber | Sallaku | 751 | 572 | 15,5 | 30 | 465 | 2400 | 1116000 |
| 3. | Riza | Ramazan | Alvora | 980 | | 16 | 10 | 160 | 2400 | 384000 |
| 4. | Ahmet | Ramazan | Alvora | 990 | | 16 | 10 | 160 | 2400 | 384000 |
| 5. | Sefer | Islam | Alvora | 1010 | | 13 | 5 | 65 | 2400 | 156000 |
| 6. | Jonuz | Islam | Alvora | 1015 | | 13 | 5 | 65 | 2400 | 156000 |
| 7. | Mikelin | Kol | Shestani | 1038 | | 19,77 | 51,6 | 1020,132 | 2400 | 2448316,8 |
| | | | | | | | | | | |
| | Shuma: | | | | | | | 2467,132 | | 5921116,8 |

Kryeplaku
Osman Hasrama

Agronomi
Mustafa Shera

Inxhinier
Agim Shehu

Kryetar i Bashkisë Vorë
Kujtim Mema

VENDIM
Nr.231, datë 11.5.2000

PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUdhËN E PROVËS

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Planifikimi i nevojave dhe përcaktimi i kriterëve

1. Drejtoritë e personelit në institucionet e administratës qendrore përgatisin planin e nevojave për pranimet në shërbimin civil për vitin e ardhshëm deri në datën 31 korrik të çdo viti dhe e paraqesin atë në Departamentin e Administratës Publike deri në datën 1 tetor.

2. Ky plan përmban një listë të pozicioneve të lira, të shoqëruara me përshkrimin e punës dhe me specifikimin e profesioneve të nevojshme, sipas këtij përshkrimi.

3. Në raste të veçanta, për shkak të largimit nga shërbimi civil, të dhënies së dorëheqjes, në rast vdekje, paaftësie të përhershme për të kryer detyrat zyrtare, për shkak të kushteve shëndetësore, apo në rast të heqjes ose të kufizimit të zotësisë për të vepruar të nëpunësve, menjëherë me krijimin e vendit të lirë institucioni i administratës qendrore paraqet një kërkesë në Departamentin e Administratës Publike. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Procedura e pranimin në shërbimin civil realizohet sipas planifikimit të bërë nga Departamenti i Administratës Publike, në bazë të planit të pranimeve dhe të kërkesave të çdo institucioni.

5. Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të personelit dhe me eprorin e drejtpërdrejtë përkatës, përcakton kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, fushat dhe datën kur do të zhvillohet konkurimi. Përcaktimi i këtyre kërkesave mbështetet në përshkrimin e punës për vendin e lirë. Në institucionet e pavarura kërkesat e veçanta, që duhet të plotësojnë kandidatët, fushat dhe data kur do të zhvillohet konkurimi përcaktohen nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, në bashkëpunim me eprorin e drejtpërdrejtë nga varet vendi i lirë.

Shpallja e konkurimit për vendin e lirë

6. Shpallja e konkurimit për vendin e lirë përmban këto të dhëna:

a) Një përshkrim të shkurtër të vendit të punës: pozicioni, sektori, drejtoria dhe institucioni;

b) Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 12, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil";

c) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, në bazë të përshkrimit të punës për vendin e lirë;

ç) Lista e dokumentave që duhen të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet. Afati duhet të jetë jo më pak se 30 ditë nga data e botimit të shpalljes për konkurim;

d) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të futen në testim, data dhe vendi i zhvillimit të testimit;

dh) Fusha e njohurive që do të testohen, llojet e testeve, si dhe bibliografia përkatëse;

7. Departamenti i Administratës Publike, me shpenzimet e institucionit të vendit të lirë, boton shpalljen e konkurimit për vendin e lirë në dy gazeta, me qarkullim më të madh kombëtar. Botimi bëhet të paktën 40 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e testimit, tri ditë me radhë. Në institucionet e pavarura botimi bëhet nga departamenti, drejtoria, seksioni, apo zyra e personelit.

Përzgjedhja e kandidatëve, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara
në shpalljen e konkurimit

8. Departamenti i Administratës Publike bën verifikimin paraprak të kandidatëve, të cilët, në bazë të fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura, përmbushin kërkesat, e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen e konkursit. Në institucionet e pavarura përzgjedhja paraprake bëhet nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit.

9. Kandidatët, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe që do të marrin pjesë në testim, renditen sipas rendit alfabetik. Personat që nuk plotësojnë kërkesat e mësipërme renditen në një tjetër listë ku tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Listat e mësipërme shpallen në kohën dhe sipas mënyrave të përcaktuara në shpalljen e konkurimit.

10. Brenda dy ditëve nga shpallja e listave, personat e interesuar mund të paraqesin ankesat në Departamentin e Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose në departamentin, drejtorinë, seksionin apo zyrën e personelit, për institucionet e pavarura. Ankesat zgjidhen brenda 3 ditëve nga depozitimi i tyre. Paraqitja e ankesave të mësipërme nuk prek të drejtën e ankimit, sipas pikës 22 të këtij vendimi.

Testimi

11. Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, krijojnë komitetet ad hoc të testimit. Këto komitete kanë këtë përbërje:

a) një përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike, për institucionet qendrore, ose një përfaqësues të departamentit, drejtorisë, seksionit apo zyrës së personelit, për institucionet e pavarura;

b) dy pedagogë nga fakulteti, sipas fushës ku do të zhvillohet testimi, të përcaktuar nga dekanati përkatës apo dy profesionistë të njohur në fushën përkatëse, të përcaktuar nga fakultetet apo institucionet e tjera, arsimore, sipas kërkesës së Departamentit të Administratës Publike, për institucionet qendrore, ose të departamentit, drejtorisë, seksionit apo zyrës së personelit, për institucionet e pavarura;

c) dy përfaqësues të institucionit të vendit të lirë, të caktuar nga sekretari i përgjithshëm i institucionit ose nga nëpunësit e një pozicioni më të lartë se ai për të cilin zhvillohet testimi ose, ne pamundësi, nga nëpunësit më me përvojë të institucionit. Në rastin kur procedura e pranimit zhvillohet për pozicionin e sekretarit të përgjithshëm, përfaqësuesit e institucionit caktohen nga titullari apo organi drejtues i institucionit, sipas kushteve të mësipërme.

12. Për garantimin e paanshmërisë së veprimtarisë së anëtarëve të komitetit ad hoc zbatohen nenet nga 37 deri te 43, të Kodit të Procedurave Administrative. Departamenti i Administratës Publike, në institucionet e administratës qendrore, ose departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, në institucionet e pavarura, kërkon plotësimin e anëtarit, sipas pikës 11 të këtij vendimi.

13. Në fillim të çdo procedure konkurimi anëtarët e komitetit ad hoc zgjedhin kryetar njërin nga dy përfaqësuesit e institucionit të vendit të lirë. Komiteti ad hoc merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve.

14. Personat e përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 11 të këtij vendimi, shpërblehen me 10 për qind të pagës së drejtorit të Departamentit të Administratës Publike. Të gjitha shpenzimet përballohen nga buxheti i institucionit që ka vendin e lirë.

15. Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, i paraqet komitetit ad hoc listën e kandidatëve, të cilët do të marrin pjesë në testim

16. Testimi zhvillohet me shkrim e me gojë, në ditën dhe në vendin e caktuar në shpalljen e konkursit. Komiteti ad hoc përcakton me shkrim subjektet e testimit në këto fusha:

a) Njohuri në fushën e specialitetit dhe të kërkesave të veçanta, të përcaktuara për vendin e lirë.

b) Njohuri për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative dhe për legjislacionin dhe funksionimin e administratës publike.

17. Pikët maksimale, të mundshme janë:

- a) 70 pikë nga rezultati i testimit;
- b) 10 pikë nga përvoja në punët e kandidatit;
- c) 8 pikë nga kualifikimet;
- ç) 8 pikë nga publikimet shkencore;
- d) 4 pikë nga aftësitë personale, të veçanta.

18. Komiteti ad hoc përgatit një listë të kandidatëve, sipas rezultateve të arritura, duke filluar nga ai me më shumë pikë. Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta renditja bëhet sipas rezultateve të hedhjes në short. Lista e renditur e kandidatëve shpallet në një vend të dukshëm, të caktuar, në ndërtesën, ku është zhvilluar testimi.

Vlerësimi përfundimtar

19. Tri kandidatët me rezultatet më të mira i paraqiten eprorit të drejtpërdrejtë, i cili zgjedh njërin prej tyre. Për këtë qëllim ky epror zhvillon një bashkëbisedim me secilin nga tre kandidatët e propozuar nga komiteti ad hoc. Vendimi i eprorit duhet të jetë i motivuar dhe të bazohet në parimet e barazisë, mirëbesimit dhe mosdiskriminimit. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë jepet pas verifikimit të vërtetësisë së dokumenteve, në bazë të të cilave është kryer procesi i konkurimit.

20. Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose departamenti, drejtoria, seksioni apo zyrat e personelit, për institucionet e pavarura, brenda 4 ditëve boton rezultatet e konkurimit, në dy gazetat me qarkullim më të madh kombëtar.

21. Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, nxjerr rregulla të hollësishme për mënyrën e zhvillimit të testimit.

Ankimi

22. Në rastet e ankesave për zhvillimin dhe rezultatet e konkurimit, pas shqyrtimit të tyre sipas ligjit, Komisioni i Shërbimit Civil vendos:

- a) rrëzimin e ankesës;
- b) pranimin e ankesës, kur vëren gabime në zhvillimin e konkurimit;
- c) anulimin e konkurimit, kur vëren shkelje procedurale në zhvillimin e tij.

23. Në rastin e parashikuar në shkronjën "b", të pikës 22 të këtij vendimi nëpunësi regjistrohet në një listë pritjeje për vendin e parë të lirë të të njëjtit pozicion me atë për të cilin ka konkuruar. Kjo listë mbahet nga Departamenti i Administratës Publike, për institucionet qendrore, ose departamenti, drejtoria, seksioni apo zyrat e personelit, për institucionet e pavarura, të cilët në rastin e parë, kur rezulton një vend i lirë dhe nëse kandidati përmbush kërkesat për vendin e lirë, e emërojnë kandidatin në atë vend.

24. Në rastin e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 22 të këtij vendimi, procedura e konkurimit përsëritet duke filluar nga faza ku ka patur parregullsi procedurale.

25. Vendimi i Komisionit të Shërbimit Civil botohet dhe i njoftohet të interesuarit nga Sekretariati teknik, brenda 4 ditëve.

Periudha e provës

26. Në fund të periudhës së provës, në bazë të përshkrimit të punës, të rezultateve të trajnimit dhe të vlerësimit të rezultateve individuale në punë, eprori i drejtpërdrejtë vendos:

- a) konfirmimin si nëpunës civil;
- b) largimin nga shërbimi civil;
- c) shtyrjen e periudhës së provës deri në gjashtë muaj të tjerë, një herë të vetme, kur është i mendimit se nëpunësi ka nevojë për një periudhë prove më të gjatë, për shkak të kompleksitetit të

vendit të punës.

27. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i njoftohet nëpunësit brenda 4 ditëve.

28. Në rastet e ankesave ndaj vendimit të eprorit të drejtpërdrejtë, pas shqyrtimit të tyre sipas ligjit Komisioni i Shërbimit Civil vendos:

a) rrëzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit të eprorit;

b) shfuqizimin e vendimit të eprorit dhe kthimin e nëpunësit në vendin e punës.

29. Njoftimi i vendimit të Komisionit kryhet sipas pikës 25 të këtij vendimi.

30. Instituti është i detyruar ta mbajë vendin e lirë deri në zgjidhjen përfundimtare të ankesave ose deri në mbarimin e afatit për paraqitjen e tyre.

31. Dispozitat e pikave të mësipërme zbatohen edhe në periudhën e provës për nëpunësit ekzistues, sipas afateve të përcaktuara në nenin 27, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Konfirmimi i nëpunësve ekzistues pas mbarimit të periudhës së provës kushtëzohet nga vlerësimi pozitiv i kryerjes së veprimtarive të trajnimit. Ky vlerësim pozitiv vërtetohet me certifikatën përkatëse, të lëshuar nga instituti, ku nëpunësi ka kryer trajnimin.

Dispozita të fundit

32. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 232, datë 11.5.2000

PËR DHËNIE NDIHME FAMILJEVE TË ZONAVE VERILINDORE, TË CILAT KANË HUMBUR PJESËTARË TË TYRE GJATË PERIUdhËS SË LUFTËS NË KOSOVË, SI REZULTAT I VRASJEVE OSE I SHPËRTHIMIT TË MINAVE E TË PREDHAVE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit për vitin 2000", me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T'i japë këshillit të rrethit Kukës një fond prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh, këshillit të rrethit Tropojë një fond prej 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekësh, këshillit të rrethit Has një fond prej 800 000 (tetëqind mijë) lekësh si fonde shtesë në buxhetet përkatëse të vitit 2000.

2. Fondet t'u jepen si ndihmë familjeve të personave, sipas listës e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ky fond prej 3 200 000 lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe prefektura e Kukësit për të kontrolluar zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Personat, familjet e të cilave do të ndihmohen

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati/Qyteti | Komuna/Bashkia (Rethi përkatës) | Masa e ndihmës për familjen (në lekë) |
|-----|--------|---------|-----------|---------------|------------------------------------|---|
| 1. | Lavdie | Ramadan | Lusha | Golaj | Golaj (Has) | 100 000 |
| 2. | Sadri | Besim | Ahmati | Vlohem | Golaj (Has) | 100 000 |
| 3. | Selim | Tahir | Kraja | Vlohem | Golaj (Has) | 100 000 |
| 4. | Xhem | Sadri | Bardhoshi | Letaj | Golaj (Has) | 100 000 |
| 5. | Besnik | Hamit | Bardhoshi | Letaj | Golaj (Has) | 100 000 |
| 6. | Arben | Selim | Bardhoshi | Letaj | Golaj (Has) | 100 000 |
| 7. | Merita | Mus | Cahani | Krumë | Krumë (Has) | 100 000 |
| 8. | Muse | Sadik | Cahani | Krumë | Krumë (Has) | 100 000 |

Totali i fondit për Këshillin e Rrethit Has

800 000

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati/Qyteti | Komuna/Bashkia (Rethi përkatës) | Masa e ndihmës për familjen (në lekë) |
|-----|----------|--------|-------------|---------------|------------------------------------|---|
| 1. | Lulzim | Hasan | Muhametaj | Prush | Bytyç (Tropojë) | 100 000 |
| 2. | Hysni | Adem | Hajdarmataj | Zherkë | Bytyç (Tropojë) | 100 000 |
| 3. | Shpend | Rexh | Hajdarmataj | Zherkë | Bytyç (Tropojë) | 100 000 |
| 4. | Tahir | Shaban | Hoxha | Aste | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 5. | Hysen | Ismail | Mella | Bucaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 6. | Tahir | Ram | Memia | Myhejan | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 7. | Orjon | Adem | Qelia | Papaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 8. | Arif | Shpend | Dauti | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 9. | Qazim | Hazir | Dauti | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 10. | Adem | Bajram | Selmani | Aste | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 11. | Mehmet | Ram | Dizdari | Berbat | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 12. | Ram | Rexhep | Sallahi | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 13. | Man | Arif | Sallahi | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 14. | Xhemile | Makell | Sallahi | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 15. | Hyre | Mehmet | Demiri | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 16. | Muharrem | Halil | Tafa | Vicidol | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 17. | Erlind | Rustem | Dautaj | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 18. | Dritan | Man | Lushaj | Gegaj | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 19. | Ramiz | Ram | Memia | Myhejan | Tropojë (Tropojë) | 100 000 |
| 20. | Isa | Rexhep | Hajdarmataj | | Bytyç (Tropojë) | 100 000 |
| 21. | Bilbil | Halil | Muja | B.Curri | B.Curri (Tropojë) | 100 000 |
| 22. | Renti | Qerim | Ismailgeci | B.Curri | B.Curri (Tropojë) | 100 000 |

Totali i fondit për Këshillin e Rrethit Tropojë

2 200 000

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati/Qyteti | Komuna/Bashkia (Rethi përkatës) | Masa e ndihmës për familjen (në lekë) |
|-----|---------|--------|---------|---------------|------------------------------------|---|
| 1. | Emitjal | Azem | Hoxha | Orgjost | Zapod (Kukës) | 100 000 |
| 2. | Bilal | Shaban | Murati | Shishtavec | Shishtavec (Kukës) | 100 000 |

Totali i fondit për Këshillin e Rrethit Kukës

200 000

VENDIM

Nr. 233, datë 11.5.2000

**PËR MBËSHTETJEN E SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË PLEHRAVE KIMIKE NGA
ORGANET E RUAJTJES SË RENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 20, të ligjit nr.8531, datë 23.9.1999, "Për Shërbimin e Kontrollit të Plehrave Kimike", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organet e ruajtjes së rendit ndihmojnë, me kërkesën e Shërbimit të Kontrollit të Plehrave Kimike, në rastet e parashikuara më poshtë:

a) Kur inspektori, gjatë ushtrimit të kontrollit të plehrave kimike, vëren shkelje të dispozitave të ligjit "Për Shërbimin e Kontrollit të Plehrave Kimike", dhe kundërvajtësi kundërshton urdhrin e tij.

b) Kur tregtohet pleh kimik i bllokuar ose i ndaluar për të qarkulluar në treg.

c) Kur pjesa e plehut (partia) nuk përpunohet ose asgjësohet në afatet kohore, të përcaktuara në urdhrin e Shërbimit të Kontrollit të Plehrave Kimike.

2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

VENDIM

Nr. 234, datë 11.5.2000

**PËR KRITERET DHE RREGULLAT E MARRJES SË MOSTRAVE DHE TË VLERËSIMIT
TË PLEHRAVE KIMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 dhe 10, të ligjit nr.8531, datë 23.9.1999, "Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi i plehrave kimike bëhet në bazë të analizimit në laborator të mostrës zyrtare, ku

përcaktohen të gjithë ushqyesit parësorë (N, P₂O₅, K₂O), si dhe elemente të tjera, përfshirë edhe mikroelementet, të garantuar dhe të deklaruar në etiketë ose në fletën shoqëruese të plehut.

2. Çdo pleh që prodhohet, përzihet (përgatitja e plehrave të përzierë apo të kombinuar) apo tregtohet, duhet të ketë etiketën ose fletën shoqëruese, ku të deklarohen karakteristikat e përgjithshme të tij.

3. Çdo person, fizik apo juridik, që ofron ose tregon plehra kimike, e shoqëron çdo sasi të plehut kimik me raportin e analizave për treguesit e kërkuar, të vërtetuar nga laboratorit i ngarkuar për këtë qëllim.

4. Përcaktimi nëse një pleh është me mungesa në përmbajtjen e elementeve ushqyese, ose përmban elemente të dëmshme për njeriun, kafshët, mjedisin, do të mbështetet në rezultatet e analizave të mostrës zyrtare.

5. Vlerësimi i plehut kimik të analizuar bëhet në bazë të kufijve të lejuar për çdo element dhe/ose në llogaritjen e vlerës së indeksit të përgjithshëm të plehut.

6. Plehu kimik vlerësohet me mungesë të elementit ushqyes:

a. kur vlera e analizës së çdo ushqyesi është më e ulët se vlera e garantuar dhe deklaruar (në etiketë ose në fletën shoqëruese të plehut).

b. kur vlera e indeksit të përgjithshëm është më e vogël se 97 për qind.

7. Kufijtë e lejuar të përmbajtjes së deklaruar të mikroelementeve (B, Co, Cu, Fe, Mn, Mo, Zn) janë:

a. 0.4 për qind në terma absolute, për një përmbajtje më të lartë se 2 për qind.

b. një e pesta e vlerës së deklaruar për një sasi që nuk i kalon 2 për qind.

8. Mostra zyrtare përfaqëson një sasi plehu deri në 50 tonë. Në çdo rast përgatiten tri mostra, afërsisht në të njëjtën sasi, paktohen dhe pajisen secila me etiketën përkatëse.

Mostrat mbyllen dhe vulosen në mënyrë të tillë që hapja e tyre të çojë në prishjen e vulës.

9. Për çdo mostër, inspektori harton fletën e inspektimit, në tri kopje. Një mostër, e cila duhet të peshojë të paktën 0.5 kg dhe jo më shumë se 1 kg, së bashku me një kopje të fletës së inspektimit i jepet personit, fizik ose juridik, zotërues i plehut që kontrollohet. Mostra e tretë, së bashku me një fletë inspektimi mbahet nga inspektori.

10. Marrja e mostrave bëhet në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Shërbimi i Kontrollit të Plehrave Kimike.

11. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

VENDIM

Nr. 238, datë 18.5.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.792, DATË 24.12.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË DEKLARIMIT TË PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.792, datë 24.12.1998, të ndryshohet: "Anëtarët e komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, të

shpërblehen për punën e kryer në masën 10 000 lekë në muaj. Kryetari i Komisionit shpërblehet në masën 15 për qind më shumë, kurse sekretari teknik 10 për qind më pak se anëtarët".

2. Pika 2 e vendimit nr.792, datë 24.12.1998, të ndryshohet: "Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohet një fond prej 2 216 mijë lekësh, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për shpërblimin e anëtarëve të komisionit për vitet 1999 dhe 2000".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 239, datë 18.5.2000

PËR LARGIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË SEKRETARIT TË KËSHILLIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 39 të ligjit nr.7572, datë 10.6.1992, "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor", si dhe të nenit 5, pika 9, të ligjit nr.7608, datë 22.9.1992, ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, "Për prefekurat", me propozim të ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Ruzhdi Caca, largohet nga detyra e sekretarit të këshillit të komunës Synej, rrethi Kavajë për mangësi të theksuar në organizimin e punës dhe shkelje ligjore.
2. Z.Ramazan Keta, emërohet sekretar i këshillit të komunës Synej, rrethi Kavajë.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 241, datë 18.5.2000

PËR RIORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ÇMIMEVE TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 44 dhe 45 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994, "Për barnat", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të riorganizohet Komisioni i Çmimeve të Barnave pranë Ministrisë së Shëndetësisë, i përbërë nga 9 anëtarë përfaqësues të:

| | |
|--|------------------------|
| Ministrisë së Shëndetësisë | kryetari dhe 2 anëtarë |
| Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor | 2 anëtarë |
| Ministrisë së Financave | 1 anëtar |
| Shoqatës së Farmacistëve | 1 anëtar |
| Urdhrit të Mjekut | 1 anëtar |
| Shoqatës së Konsumatorëve të Shqipërisë | 1 anëtar |
2. Drejtoria Farmaceutike e Ministrisë së Shëndetësisë mbledh dhe përpunon informacionin

për çmimet e barnave të fabrikuara në vend dhe ato të importuara dhe ia përcjell Komisionit të Çmimeve të Barnave. Ky i fundit ngarkon Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për hartimin e projektit të çmimeve referencë. Mosdhënia e informacionit për çmimet e barnave shoqërohet me sanksione ndaj fabrikuesve apo importuesve, të parashikuara në ligj.

3. Komisioni i Çmimeve të Barnave mbi bazën e listës së barnave që rimbursohen nga Sigurimet Shëndetësore dhe të çmimeve referencë të paraqitura nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor diskuton projektin, negocion për çmimet e paraqitura dhe i propozon Këshillit të Ministrave për miratim strukturën e çmimeve brenda tremujorit të parë të çdo viti.

4. Çmimet e miratuara të barnave që rimbursohen nga sigurimet shëndetësore janë të vlefshme për një vit. Ndryshimi i tyre nuk mund të bëhet më shpesh se një herë në gjashtë muaj dhe vetëm kur kushtet ekonomike të fabrikuesve vendas apo të huaj ndryshojnë, apo kur ndryshon përbërja e listës së barnave që rimbursohen nga Sigurimet Shëndetësore, mbi bazën e informacionit të hollësishëm të paraqitur nga fabrikuesit Komisionit të Çmimeve të Barnave. Çdo ndryshim i çmimeve do të miratohet me të njëjtën procedurë. Fabrikuesit vendas apo të huaj apo importuesit do të njoftohen si për nevojat për informacion shtesë ashtu dhe për vendimin e mosndryshimit të çmimit.

5. Komisioni i Çmimeve të Barnave organizon studimin e marzheve të fabrikimit dhe tregtimit dhe i propozon Këshillit të Ministrave për caktimin e tyre.

6. Çdo anëtar i Komisionit të Çmimeve të Barnave shpërblehet me 2 000 lekë nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.

7. Vendimi nr.311, datë 6.5.1996, si dhe paragrafi 2 i pikës 1 dhe pika e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.21, datë 13.1.1997 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 242, datë 18.5.2000

**PËR MBYLLJEN E DISA MINIERAVE TË BAKRIT, MINERALEVE TË TJERA DHE
FABRIKAVE TË PASURIMIT, NË RRETHET HAS, PUKË, MIRDITË, SHKODËR DHE
KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të mos konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë, dhe t'i nënshtrohen procesit të mbylljes dhe privatizimit minierat e bakrit, mineraleve të tjera dhe fabrikat e pasurimit:

a. Minierat e bakrit

- | | |
|---|---------------------|
| - Miniera e Bakrit Nikoliq 2 | - Rrethi i Hasit |
| - Miniera e Bakrit Qaf Mali-Palucë | - Rrethi i Pukës |
| - Miniera e Bakrit Tuçi Lindor | - " " |
| - Miniera e Bakrit Shmi | - " " |
| - Miniera e Bakrit Gurthi Spaç-3 | - Rrethi i Mirditës |
| - Miniera e Bakrit Perlati Verior (nëntokë) | - " " |
| - Miniera e Bakrit Rubik | - " " |
| - Miniera e Bakrit Maja e Madhe | - " " |

- Miniera e Piritit Spaç - “ “
- Miniera e Bakrit Laje Reps - “ “
- Miniera e Bakrit Rrenjollë - “ “
- Miniera e Bakrit Karma 1 - Rrethi i Shkodrës
- Miniera e Bakrit Dushku i Trashë-Rehovë - Rrethi i Korçës
- Miniera e Bakrit Çiflik-Rehovë - “ “
- b. Minierat e mineraleve të tjera**
- Miniera e Xhamit Vullkanik Qaf Bari - Rrethi i Pukës
- Miniera e Graniteve Levrushk - “ “
- c. Fabrikat e pasurimit të bakrit**
- Fabrika e Pasurimit nr.2 Fushë-Arrëz - Rrethi i Pukës
- Fabrika e Pasurimit nr.2 Reps - Rrethi i Mirditës

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda muajit korrik 2000, të fillojë procedurat e privatizimit dhe të hartojë projektet e mbylljes së këtyre minierave dhe fabrikave të pasurimit. Mbyllja e tyre të përfundojë brenda vitit 2000.

3. Mbyllja e minierave dhe fabrikave të pasurimit të përballohet nga fondet buxhetore të programuara për vitin 2000, për konservim dhe mbyllje.

4. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose të transferohen në minierat e tjera të cilat vazhdojnë aktivitetin e tyre.

5. Punonjësit, të cilët deri më datën 1.1.2000, kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në momentin e mbylljes së minierave dhe fabrikave të pasurimit, të emërtuara në pikën 1 të këtij vendimi, të trajtohen për 1 (një) vit me pagën minimale, në shkallë vendi, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Periudha njëvjeçare për punonjësit që përfitojnë sipas këtij vendimi, të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni, dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

7. Fondet prej 10 milionë lekësh, nga të cilat 4 milionë lekë për vitin 2000 dhe 6 milionë lekë për vitin 2001, për trajtimin e 90 punonjësve, që humbasin vendin e punës si pasojë e mbylljes së minierave dhe fabrikave të pasurimit do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe të vihen në dispozicion të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 246, datë 18.5.2000

PËR NDRYSHIME TË KUSHTEVE TË LIDHJES SË KONTRATAVE TË SHITJES, PËR APARTAMENTET E NDËRTUARA ME FONDE SHTETËRORE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", me propozim të ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes me Entin Kombëtar të Banesave, blerësi do të paguajë vetëm vlerën prej 4 përqind të apartamentit. Kjo vlerë është e zbatueshme pavarësisht nga tipi i kontratës së shitblerjes së apartamenteve si dhe nga statusi i strehimit të qytetarit.

2. Pas pagesës së 4 përqindëshit, shlyerja e kredisë do të vazhdojë të kryhet me këste të

rregullta mujore sipas vendimit nr.291, datë 21.6.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve të ndërtuara me fondet shtetërore" dhe udhëzimit nr.4, datë 22.4.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore".

3. Vendimi nr.528, datë 17.10.1994, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e pagesës së banesave që financohen nga Enti Kombëtar i Banesave", me ndryshimet e tij dhe vendimi nr.210, datë 1.4.1996, i Këshillit të Ministrave, "Për uljen e kështit të parë të pagesës së apartamenteve të ndërtuara me fonde shtetërore", shfuqizohen.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave dhe Organet e Pushtetit Vendor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 248, datë 18.5.2000

**PËR AKORDIM NDIHME PËR DISA FAMILJE, BANESAT E TË CILAVE JANË
DËMTUAR SI REZULTAT I FATKEQËSIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 7, të ligjit 8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000" dhe të vendimit nr.206, datë 26.3.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish", me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T'i akordojë fondin prej 31 114 776 lekë, organeve vendore të pasqyruara në kollonën A të shtojcës nr.1 (bashkëlidhur këtij vendimi), si fond shtesë në buxhetet e tyre të vitit 2000. fondet do t'i jepen si ndihmë familjeve të pasqyruara në kollonën B të shtojcës në fjalë, sipas destinacioneve të përcaktuara në kollonat C, D dhe E.

2. Të ngarkohen organet vendore për dhënien e ndihmës dhe kontrollin e përdorimit të fondeve, për personat në destinacionet e përcaktuara në shtojcën nr.1, bashkëlidhur.

3. Fondet e ndihmës për familjet e dëmtuara në bashkinë Poliçan do të akordohen nga bashkia, pasi familjet të dorëzojnë apartamentet e dëmtuara në Entin Kombëtar të Banesave nëpërmjet paraqitjes së dokumentave përkatëse, të cilat vërtetojnë heqjen dorë nga pronësia mbi këto banesa.

4. Enti Kombëtar i Banesave të marrë në dorëzim nga çdo familje apartamentet përkatëse dhe të gjithë ndërtesën-pallatin nr.3. Më pas të bëjë studimin për mundësinë e rehabilitimit të godinës dhe të ndjekë procedurat për administrimin dhe shpërndarjen e apartamenteve sipas procedurave ligjore.

5. Bashkia Poliçan e rrethit Skrapar, Komuna Tërpan e rrethit Berat, Komuna Gracen e rrethit Elbasan, Komuna Shtiqën e rrethit Kukës dhe Komuna Baz e rrethit Mat, të ndalojnë kryerjen e ndërtimeve të reja në trojet përkatëse të përcaktuara si të rrëshqitshme.

6. Ngarkohen prefekturat përkatëse për kontrollin e procedurave të zbatimit të këtij vendimi, nga organet e pushtetit vendor.

7. Fondi në total prej 31 114 776 lekë, do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

SHTOJCA NR.1

Ndihma për familjet e dëmtuara nga raste fatkeqësish

| Organi vendor të cilit do ti akordohet fondi (Rrethi përkatës) | Nr. Rendor i familjeve | Emri, Atësia, Mbiemri i kryefamiljarit të familjes së dëmtuar | Masa e ndihmës për riparim ndërtese të dëmtuar (në lekë) | Masa e ndihmës për sistemim me banesë të re (në lekë) | Masa e ndihmës për pajisje e orendi (në lekë) | Masa në total e ndihmës për këtë familje (Vlera në total për organin vendor) (në lekë) | Vërejtje |
|--|------------------------|---|--|---|---|--|----------|
| A | | B | C | D | E | | |
| BASHKIA POLIÇAN (SKRAPAR) | 1. | Vladimir Rama | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 2. | Islam Hada | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 3. | Rrapo Gorezi | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 4. | Veiz Ago | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 5. | Ferrik Ferruzani | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 6. | Veli Demiri | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 7. | Arshin Dushi | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 8. | Ylli Selenica | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 9. | Bilbil Karemani | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 10. | Flamur Guri | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 11. | Tefta Çela | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 12. | Hikmet Basha | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 13. | Shahin Guri | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 14. | Neki Molla | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 15. | Agim Shabani | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |

| | | | | | | | | |
|--|-----|---------|------------|---|-----------|---------|-------------------|--|
| | 16. | Hajri | Hoxha | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 17. | Islam | Senka | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 18. | Dilaver | Dyneku | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 19. | Tomorr | Lulaj | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 20. | Sali | Xhaferri | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 21. | Hazis | Kuçi | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 22. | Butjon | Naska | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 23. | Palush | Bregu | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 24. | Shemsi | Ibro | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 25. | Lutfi | Doko | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 26. | Artur | Mullai | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 27. | Fatmir | Ago | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 28. | Zenel | Zylyftari | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 29. | Azis | Caushllari | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| | 30. | Astrit | Spahiu | 0 | 567 630 | 0 | 567 630 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Bashkinë Poliçan në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | | 17 028 900 | |
| | | | | | | | | |
| KOMUNA TËRSPAN (BERAT) | 1. | Sami | Kurti | 0 | 599 500 | 0 | 599 500 | |
| | 2. | Neki | Kurti | 0 | 599 500 | 0 | 599 500 | |
| | 3. | Xhevair | Kurti | 0 | 599 500 | 0 | 599 500 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Tërpan në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | | 1 798 500 | |
| | | | | | | | | |
| KOMUNA HOTOLISHT (LIBRAZHD) | 1. | Zeqir | Emin Alliu | 0 | 827 491 | 100 000 | 927 491 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Hotolisht në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | | 927 491 | |
| | | | | | | | | |
| KOMUNA GRACEN (ELBASAN) | 1. | Sadi | Osman Alla | 0 | 1 039 720 | 0 | 1 039 720 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Gracen në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | | 1 039 720 | |
| | | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|--|----|----------------------|---------|---------|---------|------------------|--|
| KOMUNA FUSHË-KUQE (KURBIN) | 1. | Gjon Pjetër Vasia | 0 | 254 100 | 60 000 | 314 100 | |
| | 2. | Dod Gjon Vasia | 0 | 300 300 | 100 000 | 400 300 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Fushë-Kuqe në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 714 400 | |
| KOMUNA UNGREJ (LEZHË) | 1. | Gjin Pal Çuni | 0 | 666 672 | 40 000 | 706 672 | |
| | 2. | Mark Ndrec Nikolli | 0 | 851 722 | 100 000 | 951 722 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Ungrej në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 1 658 394 | |
| KOMUNA ZALL-BASTAR (TIRANË) | 1. | Rexhep Selim Gjeçi | 911 671 | 0 | 100 000 | 1 011 671 | |
| | 2. | Gëzim Selim Gjeçi | 454 098 | 0 | 20 000 | 474 098 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Zall-Bastar në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 1 485 769 | |
| KOMUNA RASHBULL (DURRËS) | 1. | Fadil Karaman Biba | 91 800 | 0 | 100 000 | 191 800 | |
| | | | | | | | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Rashbull në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 191 800 | |
| KOMUNA HAJMEL (SHKODËR) | 1. | Pjetër Gjergj Prendi | 643 500 | 0 | 100 000 | 743 500 | |
| | | | | | | | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Hajmel në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 743 500 | |
| KOMUNA BËRDICË (SHKODËR) | 1. | Tom Kol Oka | 427 445 | 0 | 60 000 | 537 445 | Në total është përfshirë dhe një ndihmë prej 50 000 lekë për personin që ka humbur jetën |
| | | | | | | | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Bërdicë në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 537 445 | |
| KOMUNA BUSHAT (SHKODËR) | 1. | Gjon Nikoll Shkreli | 0 | 643 500 | 100 000 | 793 500 | Në total është përfshirë dhe një ndihmë prej 50 000 lekë për personin |
| | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|--|----|-------------------------|---------|---------|---------|------------------|--------------------|
| | | | | | | | që ka humbur jetën |
| | 2. | Angjelin Rrok Gjeçaj | 0 | 643 500 | 100 000 | 743 500 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Bushat në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 1 537 000 | |
| | | | | | | | |
| KOMUNA SHALË (SHKODËR) | 1. | Age Vat Mani | 419 665 | 0 | 20 000 | 439 665 | |
| | 2. | Pranda Pal Mani | 419 665 | 0 | 20 000 | 439 665 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Shalë në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 879 330 | |
| | | | | | | | |
| KOMUNA BUJAN (TROPOJË) | 1. | Rasim Xhem Ahmetaj | 0 | 919 974 | 100 000 | 1 019 974 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Bujan në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 1 019 974 | |
| | | | | | | | |
| KOMUNA SHTIQEN (KUKËS) | 1. | Bedri Isuf Muja | 0 | 547 050 | 0 | 547 050 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Shtiqen në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 547 050 | |
| | | | | | | | |
| KOMUNA KARBUNARË (LUSHNJË) | 1. | Sherife Jonuz Gorovelli | 178 842 | 0 | 100 000 | 278 842 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Karbunarë në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 278 842 | |
| | | | | | | | |
| KOMUNA BAZ (MAT) | 1. | Cub Bajram Doçi | 0 | 289 990 | 0 | 289 990 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Baz në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 289 990 | |
| | | | | | | | |
| KOMUNA MOGLIC (KORÇË) | 1. | Agim Nezir Beqiraj | 336 671 | 0 | 100 000 | 436 671 | |
| Totali i fondit që do të akordohet për Komunën Moglicë në buxhetin e vitit 2000 | | | | | | 436 671 | |

VENDIM
Nr. 253, datë 18.5.2000

PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË PLEHRAVE KIMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 7 dhe 20, të ligjit nr.8531, datë 23.9.1999, "Për Shërbimin e Kontrollit të Plehrave Kimike", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi i Kontrollit të Plehrave Kimike është pjesë e strukturës organizative të Institutit të Tokave dhe përbëhet nga administratorët, inspektorët dhe punonjësit ndihmës.
 2. Administratorët, inspektorët dhe punonjësit ndihmës emërohen nga këshilli drejtues i Institutit të Studimit të Tokave, me propozimin e drejtorit të këtij institucioni.
 3. Numri i punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Plehrave Kimike të jetë 9 (nëntë) administratorë, 5 (pesë) inspektorë dhe 3 (tre) punonjës ndihmës.
 4. Paga e administratorëve caktohet në bazë të vendimit nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", pika 4, paragrafet 1 dhe 2. Fondi për pagat përballohet nga buxheti i vitit 2000, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.
 5. Paga e inspektorëve dhe punonjësve ndihmës vendoset nga këshilli drejtues i Institutit të Studimit të Tokave, në raport me të ardhurat që krijohen gjatë veprimtarisë së Shërbimit të Kontrollit të Plehrave Kimike.
 6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Instituti i Studimit të Tokave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 254, datë 18.5.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.552, DATË 14.11.1994, TË KËSHILLI TË
MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PRODHIMIN, SHUMËZIMIN,
PËRPUNIMIN, VLERËSIMIN, TREGTIMIN, KONTROLLIN E FARAVE TË FIDANËVE
DHE PËR RUAJTJEN E TRAJTIMIN E MATERIALIT GJENETIK BIMOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 dhe 25, të ligjit nr.7659, datë 12.1.1993, "Për farat dhe fidanët", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas paragrafit të parë të nenit 6, të rregullores, "Për prodhimin, shumëzimin, përpunimin, vlerësimin, tregtimin, kontrollin e farave e fidanëve dhe për ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor", shtohet ky paragraf.

"Anëtarët dhe sekretari i komisionit të farave dhe fidanëve shpërblehen në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje të komisionit.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U dorëzua për shtyp më 5.6.2000
Doli nga shtypi më 6.6.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 200 lekë